



British Embassy
Skopje



Женска граѓанска иницијатива
Iniciativa qytetare e femrave
Women's Civic Initiative

ВОДИЧ - UDHËZUES - GUIDE

РОДОВО ОДГОВОРНИ ПОЛИТИКИ = СОЦИЈАЛНА ПРАВДА !
POLITIKA TË PËRGJEGJËSHME GJINORE = DREJTËSI SOCIALE !
GENDER RESPONSIVE POLICIES = SOCIAL JUSTICE !





British Embassy
Skopje



Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

UDHËZUES

POLITIKA TË PËRGJEGJËSHME GJINORE = DREJTËSI SOCIALE !

Shtator 2015,
Shkup

Projekt financiarisht i mbështetur nga:
Ambasadës e Britanike në Shkup

Projekti i realizuar nga:
Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

Ambasada Britanike në Shkup ka mbështetur përgatitjen e këtij publikimi në kuadër të projektit “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna”. Përmbajtja e këtij materiali nuk pasqyrojnë domosdo qëndrimet apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

Publikim : Udhëzues - Politika të përgjegjëshme gjinore = drejtësi sociale !

Botues: Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

Rr., Vukovarska“ 23/1-2

1000, Shkup

Tel: ++ 389 (0)2 2 614 641; ++ 389 (0)2 2 611 130

e-mail: antico@t-home.mk ; contact@antiko.org.mk

www.antiko.org.mk

Facebook: WCI.ANTIKO

Twitter: WCI_ANTIKO

Redaktor :

Gjyner Nebiu

Aleksandra Jovevska

Tekstet janë përpiluar dhe përshtatur nga autorët:

Vesna Jovanova

Neda Maleska-Sachmaroska

Riste Jurukovski

Gordana Gapik Dimitrovska

Përkthimi dhe përshtatja në shqip : Luljeta Klica

Përkthimi dhe përshtatja në anglisht : Daniela Brajkovska

Dizajni, përgaditja teknike dhe shtypi: Magna Sken

Tirazhi: 150 egzemplar

Tirazh që jepet falas/ jokomercijal

PËRMBAJTJA

PARATHENJE	4
HYRJE	5
 KONCEPTI THEMELOR I GJINISË DHE ZHVILLIMIT dhe QASJA NË KRIJIMINE	
POLITIKAVE TË PËRGJEGJSHME GJINORE	8
1. KONCEPTET GJINORE	8
1.1. Analiza e gjinisë dhe zhvillimit	8
1.2. Veglat e gjinisë dhe zhvillimit për analizë dhe modele analitike	9
2. TERME KYÇE TË RAPORTEVE GJINORE DHE ZHVILLIMIN	9
3. PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS GJINORE NE RRJEDHAT KRYESORE TË SHOQËRISË	10
4. ÇFARË ËSHTË ANALIZA GJINORE?	12
5. KORNIZA E ANALIZËS GJINORE	13
6. LISTË KONTROLLI PËR PLANIFIKIM DHE ORGANIZIM	17
7. METODA PËR ZBATIMIN E ANALIZËS SISTEMETIKE PËR BARAZI GJINORE	19
8. BUXHETIM I PËRGJEGJSHËM GJINORË	23
 PËRFSHIRJA E ASPEKTEVE GJINORE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE LOKALE	25
1. PËRFSHIRJA E ASPEKTEVE GJINORE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE LOKALE	25
2. PESË HAPAT DREJT KRIJIMIT TË POLITIKAVE DHE BUXHETEVE TË ORIENTURA DREJT GJINISË	26
 VLERSIMI I NDIKIMIT MBI LEGJISLACIONIN (VNML)	30
1. Historia	30
2. Çka është VNML?	30
3. Korniza juridike	31
4. Zbatimi i VNML -së	31
5. Çka është ENER ??	37
6. ÇKA ËSHTË - DEMOKRATIJA	38
 MONITORIMI DHE VLERSIMI I POLITIKAVE PUBLIKE	40
1. DEFINIMI I MONITORIMIT DHE VLERSIMIT	40
2. PLANIFIKIMI I MOTORIMIT DHE VLERSIMIT	41
3. KRITERET PËR MONITORIM DHE VLERSIM	43
4. SISTEMI PËR GRUMBULLIMIN E INFORMACIONEVE	45
5. ANALIZA E INFORMACIONEVE TË GRUMBULLUARA	48
6. MJETE PËR QASJE CILËSORE NË VLERSIMIN E NDIKIMIT	49

PARATHËNIE

Ideja për publikimin e Doracakut: „**Politika të përgjegjshme gjinore = drejtesi sociale !**” lindi si nevojë për mbështetje plotësuese të administratës lokale, këshilltarëve, veçanërisht anëtarëve të komisioneve për mundësi të barabartë të burrave dhe grave dhe organizatat e sektorit civil në Kërçovë dhe Manastir, që njëherë janë edhe grupet qëllimore të këtij projekti “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna”, të cilën Iniciativa qytetare femrave ANTIKO me mbështetje nga Ambasada Britanike në Shkup e zbaton në komunën e Kërçovës dhe të Manastirit në periudhën 2015-2016.

Synimi kryesor i projektit është: Dizajnimi i një modeli dhe pilotim i qasjes pjesëmarrëse bazuar në dëshmi për krijimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve efektive gjinore për fuqizim ekonomik të grave në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Duke u nisur nga fakti se investimi në fuqizimin ekonomik të grave e përcakton rrugën e drejtpërdrejtë kah barazija gjinore, çrrënjësja e varfërisë dhe i ndihmon rritjes inkluzive ekonomike. Doracaku fillimisht i dedikohet aktorëve dhe palëve të përfshira në NJVL- Kërçovë dhe Manastir. Njëkohësisht, lehtë mund të përshtatet dhe të përputhet edhe me intervenime tjera, që kanë efekte ndaj çështjeve gjinore. Doracaku është i dobishëm edhe për sektorin civil, institucionet lokale, sektorin e biznesit dhe të gjithë ato që interesohen, e kanë për detyrë apo mision, krijimin, zbatimin, vlerësimin e ndikimit, vëzhgimin dhe evaluimin e politikave, gjegjësisht të gjithë ato që kanë për synim dhe detyrë të krijojnë ambient të volitshëm për iniciimin e ndryshimeve të bazuara në rezultate të qëndrueshme, mundësi të barabartë, avancimin e të drejtave të njeriut/grave dhe kontribut drejt arritjes së barazisë gjinore në tregun e punës dhe drejtësisë sociale.

Me krijimi i politikave dhe programeve të përgjegjshme gjinore lokale, nënkuptohet përfshirja e aspekteve gjinore në të gjitha fazat e proceseve, duke filluar nga krijimi i vizioneve për ndryshime, analiza të bazuara në dëshmi, definimin e skenarëve, marrjen e vendimeve, menaxhimin me rreziqe e deri në vlerësimin e ndikimit, vëzhgimit dhe evaluimit.

Doracaku „**Politika të përgjegjshme gjinore = drejtesi sociale !**” ka për qëllim që të kap pikën fillestare, përkatësisht kornizën e nevojshme teorike dhe këshillën praktike për lëvizjen e procesit në krijimin e ndryshimeve, ndjekjen dhe matjen e politikave dhe ndikimin e tyre ndaj grave dhe burrave, gjegjësisht njohuri elementare që do t’u ndihmojnë aktorëve lokal në procesin e përfshirjes të perspektivës gjinore në strategjitë, programet, projektet dhe plan- veprimet e tyre (gender mainstreaming).

Temat dhe përmbajtjet e përpunuara në bazë të njohurive dhe dëshmive të fituara nga dy hulumtimet e realiyura në terren, që Antiko i zbatoi në suazat e projektit¹.

Informacionet dhe rezultatet e fituara nga hulumtimi, shërbyen si bazë për zhvillimin e programit për trajnim, i përshtatur për nevojat për përf forcimin e kapaciteteve të protagonistëve lokal dhe palëve të përfshira në komunën e Kërçovës dhe Manastirit.

Doracaku “**Politika të përgjegjshme gjinore = drejtesi sociale !**” përmban tri pjesë komplementare. Së pari shpjegohen konceptet elementare të gjinisë dhe zhvillimit si dhe qasja drejt krijimit të politikave të përgjegjshme gjinore në nivel lokal; pjesa e dytë ka të bëjë me vlerësimin e ndikimit të legjislacionit, ndërsa pjesa e tretë ka të bëjë me vëzhgimin- monitorimin dhe evaluimin e politikave publike. Doracaku është përpiluar në bashkëpunim dhe në mbështetjen e ekipit të trajnuesve/ ekspertëve që kanë përvojë shumëvjeçare në këto tri fusha. Doracaku paraqet përmbledhje të teksteve të nxjerra nga më shumë doracakë, ku pjesa më e madhe e përmbajtjeve janë nxjerrë nga doracakë ku anëtarët e ekipit, njëherë janë edhe autorët e tyre.

Ekipi i proektit të

Iniciativës qytetare të femrave ANTIKO

¹ Raport nga hulumtimi : “Mundësitë dhe pengesat e përfshirjes së grave në tregun e punës ne komun e Manastirit” dhe :” Mundësitë dhe pengesat e përfshirjes së grave në tregun e punës ne komun e Kërçovës”

HYRJE

Pse është e rëndësishme që të miratohen masa dhe programe të posaçme për fuqizim ekonomik të grave dhe arritjen e barazisë gjinore në tregun e punës?

(Pa)barazia dhe mundësitë (jo) të barabartë mes burrave dhe grave janë fenomene globale që nuk i tejkalojnë as shoqëritë më të zhvilluara moderne demokratike. Barazia mes burrave dhe grave është pjesë e korpusit për të drejtat e njeriut dhe ka të bëjë me trajtimin e barabartë dhe sigurimin e qasjes së barabartë deri tek mundësitë dhe dobitë në shoqëri, të vërtetuar me legjislacionin dhe politikat e shtetit.

Të drejtat e trajtimit dhe mundësitë e barabartë paraqesin të drejtat fundamentale të njeriut, të pranuar dhe mbrojtura nga shumë norma ndërkombëtare dhe kombëtare ku barazia gjinore theksohet si një prej elementeve fundamentale në proceset e reformave. Për fat të keq, diskriminimi në bazë të gjinisë edhe më tej ngel sfidë e madhe në aspekte dhe fusha të ndryshme të jetës së përditshme shoqërore. Gjinia si shënues primar i shtresës shoqërore dhe ekonomike, që shpesh rezulton me përjashtim, është veçori e shumë shoqërive, në të shumtën e rasteve me pozicionim më të mirë të burrave në hierarkinë shoqërore, ekonomike dhe politike.

Barazia gjinore në tregun e punës

(Pa)barazia gjinore në tregun e punës është e fuqishme dhe prezent në shumë shoqëri. Edhe pse në dekadat e fundit shënohet avancim i dukshëm në promovimin e barazisë gjinore në sferën ekonomike dhe rritje të dukshme të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, gratë në krahasim me burrat edhe më tej janë të përfaqësuara në punësime të pasigurta dhe joformale, që karakterizohet me të ardhura më të ulëta dhe imazh më të vogël. Kjo ndodh sepse gratë edhe më tej ballafaqohen me vështirësi dhe barriera në qasjen e barabartë në mundësitë për punësim cilësor. Dhe pikërisht për këtë nevojiten përpjekje serioze që të sigurohet barazia gjinore në tregun e punës.

Ekzistojnë shumë dëshmi se rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, por edhe cilësia e punësimit, jo vetëm që ka ndikim pozitiv ndaj fuqizimit ekonomik të grave, por edhe nxit përparësi më të mëdha ekonomike dhe shoqërore. **Për t'u ballafaquar me pabarazitë e vazhdueshme ndërmjet grave dhe burrave, në të shumtën e rasteve nënkupton që të punohet në mënyrë të ndryshme.**

Procesi i vendosjes së barazisë gjinore është komplekse, sikur edhe të kuptuarit dhe vlerësimi i nevojave në lidhje me mënyrën me të cilën krijohen politikat nëpër proceset shoqërore, që duhet të sigurojnë barazi gjinore. Pas kësaj, barazia gjinore nuk duhet të kuptohet se gratë dhe burrat janë identik, por si pranim dhe vlerësim të barabartë të dallimeve mes grave dhe burrave dhe rolet e tyre të ndryshme shoqërore. Kjo nënkupton se barazia gjinore promovon realisht partneritetin mes grave dhe burrave dhe përgjegjësinë e ndarë në eliminimin e pabarazive në jetën publike dhe private. Për këtë shkak, është e nevojshme që të njihet se arritja e barazisë më të madhe gjinore dhe ballafaqimi me pabarazitë e vazhdueshme, shumë shpesh do të thotë të punohet në mënyrë të ndryshme me gratë dhe burrat, të njihen pengesat e ndryshme me të cilat ata ballafaqohen, por edhe nevojat e ndryshme, prioritetet, synimet dhe aspiratat.

Barazia gjinore çështje e drejtësisë sociale dhe respektimit të së drejtave elementare të njeriut!

Çështja e barazisë gjinore nuk është çështje vetëm e drejtësisë sociale. Kjo është çështje e rëndësishme për të drejtat themelore të njeriut, dhe sidomos është e rëndësishme në ballafaqimin me varfërinë dhe papunësinë, sigurimin e mundësive të barabartë dhe jetës cilësore për të gjithë. Fuqizimi ekonomik i grave është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe zbutjen e varfërisë në tërësi. Si pikënisje për fuqizimin ekonomik të grave është zhvillimi dhe zbatimi i politikave të shëndosha publike, që nënkupton përkushtim afatgjatë, qasje specifike holistike në integrimin e perspektivës gjinore gjatë dizajnimit të politikave publike dhe programeve.

Që të kemi avancim të vërtetë në këtë fushë, gratë duhet të kenë qasje të barabartë në mjetet dhe shërbimet (tokë, ujë, teknologji, inovacion dhe kredi, mbështetje bankare dhe financiare dhe mjete apo shërbime tjera përkatëse). Kjo qasje dhe mënyrë e veprimit do t'i përforcojë të drejtat e grave, do të rris produktivitetin e tyre ekonomik, do të zbus varfërinë nëpër familje dhe do të jetë kontribut i madh për ngritjen e rritjes ekonomike të bashkësisë lokale dhe shoqërisë në tërësi.

Gratë ballafaqohen me barriera të ndryshme për shkak të roleve dhe raporteve tradicionale patriarkale
Mundësitë për punësim të grave patjetër duhet të përmirësohen përmes njoftimit dhe pranimi të punës së madhe që ato e investojnë për mirëmbajtjen e familjes dhe zhvillimin e komunitetit përmes punës së papaguar. Ato ballafaqohen me barriera të ndryshme thuajse në çdo aspekt të punës.

Mundësitë për dalje në tregun e punës të grave patjetër duhet përmirësuar sepse gratë për shkak të roleve të ndara tradicionale gjinore që i kanë në jetën e përditshme familjare, investojnë mund të madh përmes punës së papaguar dhe afatgjate (siç është mirëmbajtja e shtëpisë, pastrimi, gatimi, kujdesi ndaj të moshuarve, të sëmurëve etj). Këto janë sfida të rëndësishme që duhet të kihet parasysh gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave, programeve dhe planeve për fuqizim ekonomik të grave sepse ato kanë ndikim të madh në arritjen e rezultateve në këtë fushë.

Investime efektive për zhvillimin e qasjeve inovative dhe partneritete, rritja e dialogut dhe bashkëpunimit mes aktorëve, koordinimi mes palëve të përfshira dhe donatorëve

Që të tejkalohen barrierat ekzistuese shekullore dhe sfidat që gjenden para grave në veçanti në sferën e pavarësisë ekonomike dhe varfërinë ekzistuese të grave është shumë e rëndësishme që të miratohen qasje të reja në krijimin dhe implementimin e politikave dhe krijimin e mundësive të barabarta për rritjen e fuqisë ekonomike të grave. Që të arrihen rezultate të qëndrueshme nevojitet politikat të zhvillohen në bazë të dëshmive gjegjësisht analizave gjinore, investime efektive për zhvillimin e qasjeve inovuese dhe partneriteteve, rritja e dialogut dhe bashkëpunimit mes aktorëve, koordinimi mes palëve të përfshira dhe donatorëve. E gjithë kjo çon në qasje të integruar në organizimin dhe përforsimin e grave për pjesëmarrjen e tyre aktive në tregun e punës.

**Ekipi programor i
Iniciativës qytetare të femrave ANTIKO**

**KONCEPTI THEMELOR I GJINISË DHE ZHVILLIMIT
QASJE NË KRIJIMIN E POLITKAVE TË
PËRGJEGJSHME LOKALE**

**Vesna Jovanova
Neda Maleska Saçmaroska**

KONCEPTET GJINORE

1. GJINIA

Çfarë është gjinia (gender)? Kjo fjalë për herë të parë është përdorur nga En Oukli dhe të tjerët në vitet e 70-ta për t'i shpjeguar karakteristikat e burrave dhe grave që janë të përcaktuara në aspektin social, për dallim nga ato që janë të determinuar në aspektin biologjik. Dallimi mes gjinisë (dallimet sociale) dhe seksit (dallimet biologjike) na çon në implikime shumë të rëndësishme.

Në esencë, dallimi mes gjinisë dhe seksit është bërë për të theksuar se tërë atë që e bëjnë gratë dhe burrat, dhe e tërë ajo që pritet prej tyre, me përjashtim të dallimeve të tyre të përcaktuara gjinore (lindja e fëmijëve dhe dhënia gj) mund të ndryshoj, dhe në të vërtetë ndryshoj, me kalimin e kohës dhe në përputhje me ndryshimin e faktorëve të ndryshëm social dhe kulturor.

Fjala gjini, dallim gjinor mund të bie ndesh me rezistencën. Gjuha dhe kultura zhvillohen së bashku ndërsa kjo shumë flet për supozimet e tona të rrënjësura thellë gjegjësisht se ky nocion është vendosur kohën e fundit! Por, edhe pse kjo fjalë shumë njerëzve iu tingëllon si diçka e huaj, termi fuqishëm gjën shtrirje në përvojat jetësore edhe të burrave edhe të grave. Definicioni i punës i gjinisë: njerëzit kanë lindur si femra apo meshkuj, por ato mësojnë të jenë vajza apo djem kur do të rritet në gra dhe burra. Ata mësojnë se për ta ekzistojnë sjellje dhe qëndrime përkatëse, role dhe aktivitete dhe si ata duhet të lidhen me njerëzit tjerë. Kjo sjellje e mësuar është ajo që e ndërton identitetin e gjinisë dhe që i përcakton rolet gjinore.

- Gjinia është koncept dinamik: rolet gjinore të grave dhe burrave shumë varen nga njëra në kulturën tjetër si dhe nga një grup në grupin tjetër social, në suazat e kulturës së njëjtë. Raca, klasa, rrethanat ekonomike, mosha, gjithë këto ndikojnë ndaj asaj që konsiderohet përkatëse për gruan dhe burrin. Aq më shumë, për shkak se kultura është dinamike, ndërsa me kalimin e kohës kushtet socio- ekonomike ndryshojnë edhe kornizat e gjinisë ndryshojnë me to. Gjendjet e jashtëzakonshme siç janë luftërat apo uria, në mënyrë radikale dhe shumë shpejt mund të ndryshojnë atë që gratë dhe burrat e bëjnë, edhe pse ndonjëherë (siç konsiderojnë gratë, ish luftëtare në luftën për çlirim) pas përfundimit të krizës mund t'i kthejnë qëndrimet e mëhershme. Por, ndonjëherë ndryshimet kanë ndikim permanent.
- Gjinia na ndihmon në kuptimin e dallimeve tjera: kuptimin e diferencimit gjinor dhe diskriminimit gjinor, na ndihmon ta kuptojmë diferencimin dhe diskriminimin në fushat tjera. Njerëzve iu adresohen role dhe karakteristika të ndryshme jo vetëm në bazë të gjinisë së tyre, por edhe në bazë të racës, klasës, përkatësisë etnike dhe moshës së tyre. Analizat tona sociale bëhen më të mirë, intervenimet tona sociale bëhet më të harmonizuara, kur jemi të vetëdijshëm për të gjitha mënyrat komplekse përmes të cilave shoqëria i vendos njerëzit në kategori dhe role të ndryshme dhe për mënyrat me të cilat këto role mund të jenë bazë edhe për bashkëpunim edhe për konflikt, si mes grave ashtu edhe mes burrave, të grupeve homogjene në ndonjë shoqëri të caktuar. Gratë mund të hynë në konflikt për shkak të dallimit të tyre racor apo gratë nga grupet e ndryshme etnike apo klasore mund të solidarizohen në bazë të identitetit të tyre gjinor.

1.1 Analiza e gjinisë dhe zhvillimit

Qasjet zhvillimore

Gjinia dhe Zhvillimi (GJDHZh) dhe Gratë në Zhvillimi (GNZh) zakonisht bashkërisht ndërrohen dhe zakonisht konsiderohet se përgatitja e programeve me fokus të gjinisë nënkupton të mbështeturit e sa më shumë projekte për gratë. Është shumë e rëndësishme që mbahet mend se nëse këto nocione përfshijnë vetëm “zhvillimin” ato në mënyrë të barabartë përfshijnë edhe ndihmën në kushte të jashtëzakonshme (raste urgjente).

Qasja GNZH në të shumën e rasteve tenton t'i integroj gratë në zhvillim duke krijuar më shumë resurse të cilat do të jenë në dispozicion për gratë, me qëllim që të rritet efikasiteti i grave në rolet e tyre ekzistuese. Shpesh kjo qasje rrit normën e punës të grave, e thekson pabarazinë dhe zgjeron pengesat mes burrave dhe grave.

Qasja GJDHZH tenton intervenime t'i bazojë në analizën e roleve dhe nevojave të burrave dhe grave me qëllim që t'i aftësoj gratë t'i përmirësojnë pozicionet e tyre lidhur me burrat në atë mënyrë që do ta transformojnë shoqërinë në tërësi. Kështu, GJDHZH udhëhiqet nga motivimi i fuqishëm- të punohet në planin e barazisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit.

Vetëdija gjinore

Gjinia nuk mundet thjeshtë t'u "ngjitet" modeleve ekzistuese zhvillimore, e as të shtihet në programet zhvillimore për ndihmë si komponent shtesë. Vetëdija gjinore nuk është e veçantë apo çështje shtesë për shqyrtim; ajo është mënyrë e të shikuarit, perspektivë, tërësi shenjash që na informojnë për njerëzit tjerë dhe shoqërinë. Siç vërejtëm, gjinia është në zemrën e identitetit të njerëzit dhe të gjithë shprehitë, besimet dhe veprimet. Ne këtë e marrim si të plotë. Por, megjithatë, nëse shikojmë më thellë dhe do t'i hulumtojmë supozimet tona, do të shohim se bota duket ndryshe.

Vetëdija gjinore nënkupton të shohësh me sy tjerë, që në njëfarë mënyre janë vazhdimisht të hapura që të mësojnë më shumë. Duke e shikuar punën në fushën e zhvillimit dhe ndihmën me këto sy të ri tregohet ajo që sot është mirë e njohur me shembuj të panumërt nga e tërë bota: se nevojat e grave, që dallojnë nga ato të burrave, deri para pak kohe kanë qenë të padukshme për shumicën e agjencive të planifikimit, që ka rezultuar që shumë programe zhvillimore për ndihmën, jo vetëm që nuk u kanë sjellë përmirësim grave, por se edhe më shumë e kanë përkeqësuar situatën. Kjo pikëpamje solli deri në shqyrtim të hollësishëm të zhvillimit ndaj grave dhe deri në fillimet e analizave GJDHZH

1.2 Veglat GJDHZH (Gjinia dhe zhvillimi) për analizë dhe modele analitike Ndarja gjinore e punës

Kjo ka të bëjë me llojet e ndryshme të punës që e bëjnë gratë dhe burrat, dhe vlerën e ndryshme që ajo punë e ka. Ndarja gjinore e punës dallon sikur nga një kulturë dhe shoqëri tek tjetra, ashtu edhe në suazat e të njëjtës; ajo gjithashtu ndryshon varësisht nga rrethanat e jashtme dhe me kalimin e kohës. Analiza e ndarjes gjinore të punës në cilindo grup, nga njëra anë tregon varësisht dhe bashkëpunim e ndërsjellë, por nga ana tjetër tregon edhe pabarazinë dhe konfliktet që ekzistojnë mes grave dhe burrave. Të kuptuarit e këtyre relacioneve është ajo që konsiderohet elementare gjatë planifikimit: ne patjetër duhet të dimë si mbështetja jonë do të ndikojë ndaj punës së kryer nga ana e grave dhe burrave, si intervenimet tona ndikojnë në raportet mes grave dhe burrave dhe mënyrën se si detyrat e grave dhe burrave lidhen mes vete.

“Roli i trefishtë” i grave

Kjo është mënyra e klasifikimit të llojit të punës që e kryejnë gratë. Siç u përmend, klasifikimi i këtillë zakonisht ka të bëjë me punën produktive, riprodutive dhe shoqërore. Gratë kanë “rol të trefishtë” sepse gratë sundojnë në kryerjen e punës riprodutive. Në “punën shoqërore” përfshihen të gjitha aktivitetet nga sfera publike duke filluar nga organizimi i festave dhe kujdesi ndaj të sëmurëve, duke vazhduar me lobimin tek autoritetet për shërbime, formimin e sindikatave e deri tek punët në planin politik. Mund të jetë e dobishme, nëse bëhet dallim mes të dy llojeve të punës shoqërore, siç e bën këtë K. Mozer, të ashtuquajturën udhëheqje shoqërore dhe rol në krijimin e politikës shoqërore. Mënyra me të cilën këto lloje të punëve vlerësohen kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën gratë dhe burrat i konfirmojnë prioritetet gjatë planifikimit të programeve ose projekteve. Për shembull, kujdesi ndaj fëmijëve. Duket se kjo nuk paraqet prioritet për burrat në planifikimin e projekteve, por kjo gjithashtu mund të jetë pengesë dhe t'i zvogëlojë mundësitë e grave për përfshirje nëpër ngjarjet e ndryshme.

2. TERME KYÇE TË RAPORTEVE GJINORE DHE ZHVILLIMIN

Analiza gjinore: Me këtë term nënkuptohet mënyra sistematike e kontrollimit të ndikimeve të ndryshme në zhvillimin ndaj burrave dhe grave. Pasi programet zhvillimore anojnë që për synim të tyre të hulumtimit ta marrin gruan, mësuam se gjinia ka lidhje të madhe me atë çfarë punë kryejmë, sa kohë kemi për atë dhe sa mjete financiare kemi në dispozicion për ta kryer atë punë. Analiza gjinore kërkon të dhënat të ndahen sipas gjinisë dhe të mësohet si është ndarë dhe vlerësuar puna. Analiza gjinore patjetër duhet të kryhet në të gjitha nivelet e procesit zhvillimor; patjetër duhet pyetur çdoherë se si një aktivitet, vendim apo i caktuar do të ndikoj ndaj burrave e si ndaj grave.

Pandjeshmëri për përkatësinë gjinore (gender blind): Ky është personi i cili konsideron se gjinia nuk është supozimi elementar për zgjedhje që na është mundur në shoqëri.

Gra në zhvillim (women in development): Fokusimi tek ata që e planifikojnë zhvillimin dhe kontribuojnë ndaj tij ndaj pyetjeve lidhur me gratë në zhvillim është nxitur nga botëkuptimi se kontributet e grave injorohen dhe se kjo ka sjellë në shumë dështime në përpjekjet për avancim. Projektet e grave në qasjen zhvillimore, ku të shpeshtën përfshihen gratë si pjesëmarrëse dhe konsumatore, ishin rezultat i kësaj njohurie.

Gjinia dhe zhvillimi (gender and development): Kjo qasje e ndryshon fokusin e grave si grup ndaj raporteve mes burrave dhe grave, të përcaktuar në shoqëri. Kjo qasje fokusohet në forcat sociale, ekonomike, politike dhe kulturore që përcaktojnë se si gratë dhe burrat mund të marrin pjesë në resurset dhe aktivitetet e projekteve si dhe të kenë përfitime prej tyre.

Të dhëna të ndara sipas gjinisë: Kjo ka të bëjë me informacionet e grumbulluara përmes pyetësorëve, vëzhgimit apo teknikave tjera, që i zbulojnë rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme të burrave dhe grave. Është me rëndësi të madhe që të ketë të dhëna të ndara sipas gjinisë që të mund të vlerësohet ndikimi i një projekti të caktuar ndaj grave pa marrë parasysh ndikimit të tij ndaj burrave.

Ndarja e punës: Kjo ka të bëjë me mënyrën se si është ndarë puna mes burrave dhe grave dhe si ajo vlerësohet në një kulturë apo shoqëri të caktuar. Në përgjithësi, burrat paguhet më mirë, kanë më shumë mundësi për avancim dhe më shumë gjasa që të jenë të përfshirë nëpër statistikat nacionale. Përkundër kësaj, puna e gruas të shpeshtën është e përkohshme, sezonale, me pagë të dobët, madje ajo nuk paguhet fare ndonjëherë.

Qasja dhe kontrolli: Ky koncept nënvizon mundësinë e të bërit dallim mes qasjes (p.sh mundësia që të përpunohet toka e dikujt) dhe kontrollit (p.sh të posedosh një tokë të dikujt dhe të vendosësh se si ajo të shfrytëzohet). Gratë ndoshta kanë qasje deri tek resurset, por nuk kanë kontroll ndaj tyre, kështu që nuk kanë të drejtë të sjellin vendime.

3. PËRFSHIRJA E PERSPEKTIVËS GJINORE NË ZHVILLIMET KRYESORE NË SHOQËRI

Përfshirja e perspektivës gjinore në zhvillimet politikat dhe praktikat kryesore në drejtim të arritjes së barazisë gjinore (gender mainstreaming) paraqet strategji e jo qëllim në vete.

Përfshirja e perspektivës gjinore në zhvillimet politikat dhe praktikat kryesore në drejtim të arritjes së barazisë gjinore (gender mainstreaming) paraqet strategji e jo qëllim në vete.

Kjo qasje strategjike për arritjen e barazisë gjinore për herë të parë është përmendur në Konferencën e tretë botërore të Kombeve të Bashkuara për gratë (e mbajtur në Najrobi në vitin 1985). Vitin e ardhshëm u miratua Rezoluta për punën e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për statusin e grave, që në vitin 1987-të ju bëri thirrje të gjithë trupave në sistemin e KB-ve të përpilojnë dhe zbatojnë në praktikë politike gjithëpërfshirëse për barazinë e grave dhe ta përfshijnë atë në planet e tyre afatmesme. Por, realisht kjo strategji mori rëndësi dhe peshë dhe u bë e pranuar në suaza globale pas mbajtjes së Konferencës së katërt botërore të Kombeve të Bashkuara të grave (e mbajtur në Pekin në vitin 1995). Në platformën për aksion, qeveritë dhe lojtarët tjerë thirren “që të promovojnë politike aktive dhe të dukshme për **përfshirjen e barazisë gjinore në zhvillimet, politikat dhe praktikat kryesore**, kështu që, para se të sillen vendime, të bëhet analizën për efektet ndaj burrave dhe grave”²

² Që të kuptohet esenca e kësaj strategjie është e patjetërsueshme zbardhje të shkurtë të kategorisë gjini që si mjet analitik në disiplinat shoqërore mbulon relacione sociale mes burrave dhe grave.

Gjinia është konstrukt social dhe si koncept ka të bëjë me rolet, përgjegjësitë dhe raportet e ndryshme mes burrave dhe grave në shoqëri e që dalin nga besime kulturore e tradicionale dhe normat.

Këto relacione në masë të madhe përcaktojnë nevojat, interesat dhe prioritetet e ndryshme të burrave dhe grave në shoqërinë ekonomike, politike dhe sociale. Prej këtu ky model nënvizon se nevojat dhe prioritetet e burrave dhe grave dallojnë dhe duhet të trajtohen në mënyrë të ndryshme që të mund të tërheqin dobi të ngjashme.

Për këto arsye më shumë theksohet bindja se programet e posaçme për mbështetjen e grave mjaftojnë që të tejkalohen pabarazitë që ekzistojnë në shoqëri dhe zbatohet strategjia për përfshirjen e **perspektivës** gjinore në rrjedhat kryesore të shoqërisë (gendermainstreaming).

Në këtë drejtim në vitin 1997, Këshilli ekonomik - social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) definoi përfshirjen e **perspektivës** gjinore në zhvillimet kryesore të shoqërisë (gender mainstreaming) si “proces që do t’i adresojë pasojat ndaj burrave dhe grave nga çdo aksion i planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat apo programet, në çdo fushë dhe nivel”.

Megjithatë, më shumë e përdorur dhe e pranuar gjerësisht është definicioni i Këshillit të Evropës (1998) ku thuhet: “përfshirja e perspektivës gjinore në zhvillimet kryesore (gender mainstreaming) paraqet (ri)organizim, përmirësim, zhvillim dhe vlerësim të praktikave të përgjithshme, strategjive dhe programeve, me qëllim që perspektiva gjinore që përfshihet në të gjitha nivelet dhe fazat nga ana e aktorëve të përfshirë në krijimin e atyre politikave.

Për dallim nga definicionet tjera kjo e thekson barazinë gjinore si qëllim ndërsa përfshirjen e perspektivës gjinore në zhvillimet kryesore si strategji.

Në esencë, përfshirja e perspektivës gjinore në zhvillimet kryesore (gender mainstreaming) ka për qëllim nevojat dhe përvojat e burrave dhe grave të bëhen pjesë përbërëse në formimin, zbatimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe programeve në të gjitha sferat, me qëllim që gratë dhe burrat të kenë dobi të barabartë. Prej këtui, kjo strategji punon në arritjen e drejtësisë sociale dhe demokracisë, si dhe zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm

Që të përfshihet perspektiva gjinore në zhvillimet kryesore të shoqërisë, duhet të ndërmerren këto 4 hapa kyç:

- Të zbatueshëm në të gjithë sektorët dhe kulturat
- Në nivel nacional dhe lokal në vetëqeverisjen lokale, organizatat civile dhe sektorin privat
- Të zbatueshëm në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve të përgjithshme
- Të zbatueshëm në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve të përgjithshme

Hapi 1: Informacione

Që të përfshihet perspektiva gjinore në zhvillimet kryesore të shoqërisë nevojiten të dhëna të ndara gjinore gjegjësisht të dhëna statistikore për rolet dhe raportet gjinore si dhe të dhëna analitike gjinore gjegjësisht të dhëna përshkruese që analizojnë dallimet statistikore gjinore. Këto të dhëna dhe informacione duhet të jetë pjesë rutine gjatë çdo analize.

Hapi 2: Konsultime

Gratë do të jenë në gjendje të luftojnë për barazi kur do të mund të veprojnë si të pavarura dhe me vendosmëri. Në këtë mënyrë ato do të sigurojnë që pikëpamjet e tyre të merren parasysh. Kjo do të thotë se nevojiten konsultime me gratë dhe burrat për prioritetet, nevojat dhe perspektivat e tyre si dhe përfshirjen e grave në procesin e vendimmarrjes në të gjitha nivelet

Hapi 3: Aksione për promovimin e konceptit të barazisë gjinore

Gjatë çdo intervenimi/ programi apo projekti është e patjetërsueshme që të zbulohen shkaqet për pabarazinë gjinore. Cili është problemi elementar dhe cilët janë shkaqet që duhet të adresohet me qëllim të promovimit të mëtutjeshëm të barazisë gjinore në këtë kontekst.

Hapi 4: Aksione për promovimin e përfshirjes së perspektivës gjinore në zhvillimet kryesore, në nivel të organizatës/ institucionit

Me qëllim që të aplikohen këto aksione gjegjësisht të njihet dhe adresohet çështja e raporteve gjinore në punë duhet të zhvillohet kapacitet që të përfshihen këto koncepte në politika, projekte dhe programe. Për këtë është e nevojshme të zhvillohen qëndrimet, njohuritë dhe shkathtësitë e njerëzve që punojnë në organizata dhe institucione.

4. ÇFARË ËSHTË ANALIZA GJINORE?

Analiza gjinore:

- Shqyrton dallimet në jetën e burrave dhe grave përfshirë edhe ato që çojnë drejt pabarazisë sociale dhe ekonomike të grave dhe botëkuptimi i këtillë aplikohet në zhvillimin e politikave dhe sigurimin e shërbimeve
- Ka të bëjë me shkaqet elementare për këtë pabarazi
- Ka për qëllim të arrijë ndryshime pozitive për gratë

Termi “gjinë” ka të bëjë me konstruksionin social të identitetit të gruas dhe burrit. Kjo mund të definohet si “diçka më shumë se vetëm dallimet biologjike mes burrave dhe grave”. Këtu përfshihet mënyra se si dallimet, pa marrë parasysh a janë reale apo të vërejtura, vlerësohen, përdoren dhe prej të cilave varet se si klasifikohen burrat dhe gratë dhe si ju jepen rolet dhe pritjet prej tyre. Domethënia e saj është se jetët dhe përvojat dhe grave dhe burrave, përfshirë përjetimin e tyre të sistemit juridik, paraqiten në suazat e pritjet komplekse të grupuara sociale dhe kulturore.

Me analizën gjinore pranohet se:

- Jeta e grave dhe burrave, dhe prej këtu përvojat, nevojat problemet dhe prioritetet e tyre dallojnë
- Jeta e të gjithë grave nuk është e njëjtë; interesat e përbashkët të grave patjetër duhet të përcaktohen në raport me pozitën e tyre shoqërore ose identitetin e tyre etnik, si dhe nga fakti se ato janë gra
- Përvojat jetësore, nevojat, problemet dhe prioritetet e grave janë të ndryshme tek të gjithë grupet etnike
- Përvojat jetësore, nevojat, problemet dhe prioritetet dallojnë për grupe të ndryshme të grave (varësisht nga mosha, përkatësia etnike, invaliditeti, niveli i të ardhurave, punësia/papunësia, gjendja martesore, orientimi gjinor dhe varësisht nga ajo se a kanë persona që varen financiarisht prej tyre)
- Mund të paraqitet nevoja për strategji të ndryshme që të arrihet barazi mes burrave dhe grave, por edhe për grupe të ndryshme të grave

Analiza gjinore ka për qëllim të sjell **drejtësi** e jo barazi.

Drejtësia gjinore bazohet në supozimin se burrat dhe gratë duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Por, mospranimi se nga trajtimi i barabartë nuk dalin rezultatet të barazisë çon drejt mospërfundimit sepse burrat dhe gratë kanë përvoja të ndryshme jetësore

Pse analiza gjinore?

Sot ekzistojnë disa korniza të ndryshme për analizë gjinore. Ato paraqesin vegla për zbatimin e analizës gjinore hap pas hapi ndërsa kjo ndihmon të parashtrohen pyetje, të analizohen informacionet dhe të zhvillohen strategji për pjesëmarrje të rritur të burrave dhe grave në programet e pylltarisë si dhe dobitë që dalin prej këtu.

Kornizat e analizës gjinore kanë të bëjnë me:

1. Zhvillim të kontekstit apo formular në një fushë, që jep përgjigje në pyetjen *Çfarë përmirësohet? Çfarë përkeqësohet?*
2. Aktivitetet dhe rolet e burrave dhe grave në sektorët e pylltarisë, me çka jepet përgjigje në pyetjen *Kush me çka merret?*
3. Qasja dhe kontrolli i grave dhe burrave ndaj resurseve, me çka jepet përgjigje në pyetjen. *Kush me çka posedon? Kush për çfarë ka nevojë?*, dhe
4. Aktivitetet e nevojshme për programin e pylltarisë, me çka jepet përgjigje në pyetjet *Çfarë duhet të bëhet që të tejkalohen pengesat mes nevojave të burrave dhe grave?*

Për shembull, analiza gjinore mund të shfrytëzohet në këto situata:

- Përpilim të planit për menaxhim me pyjet në nivel të fshatit, që të sigurohet probabiliteti se kontributi i burrave dhe grave pranohet në mënyrë të barabartë kur përcaktohet qasje dhe kontrolli ndaj resurseve
- Zhvillimin apo kontrollimin e politikave për pylltari, që të sigurohet pylltari e qëndrueshme përmes pjesëmarrjes së drejtë të të gjithë aktorëve
- Përcaktimin e karakteristikave të të gjithë aktorëve, që të kihet njohuri kush janë aktorët në sektorin e pylltarisë, krahas gjinisë dhe veçoritë tjera sociale.

- Ristrukturim të sektorit të pylltarisë që të sigurohet pjesëmarrje e drejtë në të gjithë nivelet, si dhe ndarje të drejtë të funksioneve të ndryshme tek gratë dhe burrat
- Përgatitjen e kriterëve për përzgjedhjen e trajnimeve apo rekrutimit që të sigurohen mundësi të njëjta për burrat dhe gratë për avancim në karrierë dhe se edhe gratë edhe burrat punojnë në role të ndryshme të sektorit e më pas punojnë edhe me burra edhe me gra të grupeve tjera të aktorëve
- **Drejtësia gjinore** merr parasysh dallimet në jetën e burrave dhe grave dhe pranon se nevojiten qasje të ndryshme që të arrihet rezultat se ato janë të drejtë. Analiza gjinore e jep bazën për një analizë të thukhtë për dallimet mes jetës së burrave dhe grave, e më pas largohet mundësia analiza të bazohet në supozime të pasaktë dhe stereotipa.

5. KORNIZA E ANALIZËS GJINORE

Korniza e analizës gjinore përbëhet nga katër pjesë dhe zbatohet në dy hapa të rëndësishëm. Së pari, grumbullohen të dhëna për Profilin e aktivitetit dhe Profilin e qasjes dhe kontrollit. Më pas këto të dhëna përdoren në analizimin e faktorëve dhe trendeve që ndikojnë ndaj aktiviteteve dhe ndaj qasjes dhe kontrollit si dhe ndaj analizimit të ciklit projektues.

Profil i aktivitetit	Çfarë bëjnë burrat e çfarë gratë (të moshuar, fëmijë, pleq) dhe ku dhe kur zhvillohen këto aktivitete.
Kush çfarë bën?	

Personi i cili e kryen planifikimin duhet t'i dijë detyrat e burrave dhe grave në nën- grupet e popullatës, në raport me fushën e dhënë në projekt, që të mund t'i drejtojë aktivitetet e projektit tek ata që bëjnë detyra konkrete. Prej këtui, patjetër duhet të grumbullohen të dhëna për përfshirjen e grave dhe burrave në çdo fazë të ciklit bujqësorë, në raport me detyrat që i ndajnë dhe detyrat që i kryejnë individualisht si dhe për nivelin deri tek i cili ndarja gjinore e punës është fiks.

Qëllimi është që të nënvizohet se gratë janë të përfshira në mënyrë aktive dhe se nuk janë të diskriminuara me të.

Profil i aktiviteteve zakonisht ka të bëjë me të gjithë kategoritë e aktiviteteve: prodhuese, riprodutive dhe shërbime të bazuara në shoqëri. Më pas përcaktohet sa kohe i dedikohet çdo aktiviteti, sa shpesh kryhet puna e dhënë (p.sh çdo ditë apo në sezon), në cilën periudhë ka kërkesë në rritje për fuqi punëtore dhe cilat kërkesa shtesë do t'u imponohen me programin e grave, burrave dhe fëmijëve.

Gjithashtu, Profili i aktivitetit përcakton vendin ku zhvillohet aktiviteti, në shtëpi apo në ndonjë vend tjetër (në fshat, treg apo në qendra urbane) si dhe distancën e atyre vendeve nga amvisëria. Këto të dhëna sigurojnë pasqyrë në lëvizshmërinë e grave dhe burrave dhe mundëson të bëhet vlerësim i ndikimit që kryhet ndaj programit në lidhje me lëvizshmërinë, mënyrën e udhëtimit, kohën e nevojshme për udhëtim për çdo aktivitet dhe cilët janë mënyrat potenciale që të kursehet në kohë.

Çështjet që shqyrtohen në suazat e Profilin e aktivitetit përfshijnë:

- Prodhimtarinë e të mirave dhe shërbimeve
- Aktivitete riprodutive dhe aktivitete për mbarëvajtjen e resurseve njerëzore
- Punë në komunitet
- Organizim dhe aktivitet në komunitet

Profil për qasje dhe kontroll Kush çfarë ka në dispozicion?	Kush ka qasje dhe kontroll mbi resurset dhe sjelljen e vendimeve
---	--

Profil për qasje dhe kontroll shqyrton resurset për produktivitet siç janë: trualli, pajisja, forca punëtore, kapitali dhe kredia si dhe arsimi dhe trajnimi. Më pas bëhet dallimi mes qasjes deri tek resurset dhe kontroll ndaj vendimmarrjes në raport me shpërndarjen dhe përdorimin e tyre. Por personave që e kryejnë planifikimin u mundësohet të shqyrtojnë nëse projekti i propozuar do ta cenoj qasjen deri tek resurset për produktivitet apo nëse mund të ndryshoj balancën e fuqisë mes burrave dhe grave në lidhje me kontrollin ndaj resurseve.

Profili shqyrton nivelin deri tek i cili gratë pengohen të marrin pjesë fillimisht në projekte. Për shembull, nëse gratë kanë qasje të kufizuara deri tek të ardhurat ose truallin, ato mund të mos kenë mundësi t'u bashkëngjiten grupeve tjera që sigurojnë kontribut ndaj prodhimtarisë dhe kanë mundësi komerciale apo mundësia e tyre të bëhen prodhues të pavarur komercial është e penguar. Në suazat e disa nën- grupeve, burrat mund të vuajnë gjithashtu nga padrejtësia e njëjtë. Mekanizmat për menaxhim me projektin (p.sh formimi i grupeve ose korporatave për shfrytëzuesit e ujit) mund të përcaktojnë kush ka qasje deri tek kontrolli i resurseve për produktivitet dhe kjo mund t'i ndryshojë raportet ekzistuese mes gjinive.

Analiza e faktorëve dhe trendeve Si është kontekstin ekonomiko-sho-qëror??	Si formulohet aktiviteti, qasja dhe kontrolli në ndikimin e faktorëve strukturorë (demografik, ekonomik, ligjorë dhe institucional) si dhe nga faktorët e kulturës, religjionit dhe qëndrimeve.
---	--

Kjo analizë shqyrton faktorët struktural dhe shoqëroro- kulturologjik që ndikojnë ndaj formularëve gjinorë dhe qasjen dhe kontrollin në fushë të caktuar të projektit:

- Faktorë demografik, përfshirë përbërjen e amvisërive dhe kokat e amvisërisë;
- Kushte të përgjithshme ekonomike, siç janë niveli i varfërisë, shkalla e inflacionit, ndarja e të ardhurave, kushtet e brendshme për tregti dhe infrastruktura;
- Faktorë kulturologjik dhe fetarë;
- Nivelet arsimore dhe shkalla e pjesëmarrjes së gjinive; dhe
- Faktorë politike, institucional dhe juridik.

Me analizë duhet të shqyrtohet:

Cilat politika dhe programe, qëllimi i të cilëve është të sigurojnë pjesëmarrje të grave, mund të ndikojnë në projekt?

Cilat norma dhe besime në komunitet mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në aktivitetet e projektit?

A ekzistojnë ligje dhe rregullore me të cilat mund të ndikohet në pjesëmarrjen e grave në projekt dhe qasja e tyre në përfitimet nga projekti?

Analizim të ciklit programor Cilat aspekte gjinore nevojiten për projektin?	Planifikim, përgatitje, zbatim, vëzhgim dhe vlerësim të projektit nga aspekti i ndjeshmërisë gjinore
--	---

Kjo analizë do të tregoj nëse dhe ku qëllimet dhe metodat e propozuara për projektin mund të modifikohen, që të përmirësohen mundësitë për sukses të projektit dhe të zvogëlohet probabiliteti se gratë do t'u bëhet padrejtësi si rezultat i kësaj.

Disa çështje që duhet të shqyrtohen në suazat e kësaj analize kanë të bëjnë me proceset prodhuese, trajnimin, informacionet, pjesëmarrjen, qasjen, ndërtimin e institucioneve, korniza e projektit etj.

Në veçanti në suazat e kornizës së projektit është e nevojshme të shqyrtohen këto çështje:

- Nëse supozimet në planifikim (p.sh në çdo nivel të kornizës për planifikim ose kornizë logjike) në mënyrë përkatëse i pasqyrojnë pengesat për pjesëmarrje të grave në program?
- A e identifikojnë treguesit për realizimin e projektit nevojën për grumbullimin e të dhënave dhe ndarjen e tyre sipas gjinisë? A do të ndiqen ndryshimet në ndarjen e punës sipas gjinisë? A do të grumbullohen gjatë projektit të dhëna për qasjen dhe kontrollin ndaj resurseve nga ana e grave?
- A mundet me projektin të përmbushen nevojat praktike lidhur me gjininë (mbështetjen dhe përmirësimin e efikasitetit të rolit të burrave dhe grave për produktivitet) dhe nevojat strategjike lidhur me gjininë (përmirësimin e barazisë gjinore përmes pjesëmarrjen e grave në projekt)?

- A ju referohen qëllimet e përgjithshme, caku dhe synimet konkrete të programit në mënyrë precize grave dhe a i reflektojnë nevojat dhe prioritetet e grave?
- A identifikohen me projektin mundësi për pjesëmarrje të grave në menaxhimin e programit, në zbatimin dhe menaxhimin me të mirat dhe shërbimet në komunitet, ku janë planifikuar ndryshimet institucionale, në mundësitë për trajnim dhe në monitorimin e resurseve dhe dobie? A do të jenë resurset e projektit relevante dhe të kapshme për gratë e varfra në raport me kuadrin, lokacionin dhe kornizën kohore?
- A përfshin projekti tregues matës për përmbushjen e qëllimeve të gjinisë dhe zhvillimit, që të lehtësohet vëzhgimi dhe vlerësimi?

Matrica për analizë gjinore

Matrica për analizë gjinore paraqet vegël analitike e cila zbaton metodologji pjesëmarrësve që të lehtësohet definimi dhe analizimi i çështjeve gjinore nga ana e komuniteteve që përfshihen në të. Përdorimi i matricës për analizë gjinore do të mundësojë artikulum të thjeshtë të të gjitha çështjeve si dhe zhvillimin e kapacitetit të analizës gjinore prej bazës e më tutje.

Matrica e analizës gjinore bazohet në këto parime:

- Tërë diturinë e nevojshme për analizën gjinore e posedojnë njerëzit, jetët e të cilëve janë lëndë e kësaj analize
- Analiza gjinore nuk imponon nevojë për ekspertizë teknike që janë jashtë komunitetit e cila analizohet, përveç rolit të tyre si fasilitatorë
- Analiza gjinore s'mund të shkaktojë transformim nëse analizën e kryejnë njerëz që kanë qenë lëndë e analizës.

QËLLIMET E PROJEKTIT:					
Qëllimet e theksuar për barazi gjinore:					
	KATEGORITË PËR ANALIZË				
	Kategoria #1	Kategoria #2	Kategoria #3	Kategoria #4	Kategoria #5
NIVELET E ANALIZËS					
Grupi i faktorëve #1					
Grupi i faktorëve #2					
Grupi i faktorëve #3					
Grupi i faktorëve #4					

hembuj për kategori:

- **Forca punëtore**

Kjo ka të bëjë me ndryshimet në detyra, niveli i shkathtësive/kualifikimeve të nevojshme (të kualifikuar përkundër të pakualifikuar, arsim formal, trajnim) dhe kapaciteti i forcës punëtore (sa është numri i njerëzve dhe sa mund të punojnë; a duhet të angazhohen njerëz apo anëtarë të amvisërisë mund ta bëjnë këtë?

- **Koha**

Kjo ka të bëjë me ndryshimet në kohën e nevojshme (3 orë, 4 ditë etj) që të zbatohet detyra që lidhet me projektin apo aktivitetin.

- **Resurset**

Kjo ka të bëjë me ndryshimet në qasjen deri në kapital (të ardhura, tokë, kapital) si rezultat i projektit dhe nivelin e kontrollit ndaj ndryshimet në resurse (më pak apo më shumë) për çdo nivel të analizës.

- **Kultura**

Faktorët kulturologjik kanë të bëjnë me ndryshimet në aspektet sociale në jetën e pjesëmarrësve (ndryshimet në rolet dhe statusin e gjinisë) si rezultat i projektit.

Parimet e analizës gjinore:

Zbatimi i analizës gjinore në organizata

Analizimi i politikave për barazi gjinore nëpër organizata dhe vende tjera na çon në përfundim se edhe krahas asaj që nuk ekziston grup konciz të sfidave të definuara, këto elemente të kornizës konceptuese konsiderohen si të rëndësishëm:

1. Llogaridhënie: Nga aspekti i menaxhimit, llogaridhënia ka të bëjë me procese të ndryshme. Në një kulturë ku drejtësia është koncept i pjekur, nuk ka ndarje të llogaridhënies në lidhje me çështjen e drejtësisë. Mirëpo, në kulturat tjera deri tani janë toleruar komente të llojit “kjo është përgjegjësi e dikujt tjetër” ose “kjo çështje i takon njësisë për çështje gjinore”. Derisa nuk integrohen përgjegjësitë që shoqërohen me llogaridhënie, vetëm pakkush që janë të dedikuar në punë do t’i zbatojnë këto përgjegjësi dhe pas kësaj do të jetë e mundur të fitohen vetëm rezultate të kufizuara. Që të tejkalohet kjo vështirësi, nevojitet që të vendoset kornizë më e gjerë e përgjegjësisë për barazinë gjinore në vet organizatën, që të promovohen forma më të thukta të llogaridhënies. Gjithashtu, është e rëndësishme për punonjësit që kanë rolet udhëheqëse dhe mbikëqyrëse ta pranojnë përgjegjësinë për politikën e barazisë gjinore dhe praktikën në suazat e njësive të tyre.

2. Zbatimi: Edhe pse barazia gjinore s’mund të jetë absolute, megjithatë bërja e krahasimit paraqet mekanizëm të fuqishëm me të cilin mund të nxitet realizimi në institucione të ngjashme. Më pas, dobitë do të dalin nga ndarja e të dhënave statistikore, politikave dhe praktikave. Miratimi i këtij parimi përfshinë analizë të politikave dhe praktikave më të mira të organizatave tjera dhe krahasimin e të dhënave. Vendosija e rregulloreve me organizata tjera, në veçanti në raport me profilin e kuadrit, mund të shërbejë si vegël e dobishme në vlerësimin e avancimit në fusha të ndryshme. Grumbullimi i informacioneve për politikën dhe praktikën nga vende tjera mund të ndihmojë për shembull në identifikimin e mënyrave të suksesshme për rritjen e numrit të grave në komisionet dhe rritjen e perspektivave për karrierë tek gratë.

3. Lidhje në rrjet: Mungesa e një rrjeti të brendshëm efektiv për barazi gjinore mund të sjell dy pasoja të padëshirueshme. Së pari, pabarazia mund të rritet për shkak të mungesës së diturisë rreth mundësive dhe e dyta efektiviteti i sistemit zvogëlohet kur organizata drejton fokusin kah këto pabarazi. Për këtë arsye, në suazat e organizatës mund të rritet lidhja në rrjet me qëllim që të ngritet vetëdija tek të punësuarit, kuptimi i tyre, lidhshmëria e tyre drejt politikave gjinore dhe parimeve si dhe vet praktika. Kjo mund të përfshin informim në tërë organizatën, vendosje të mekanizmave për komunikim me të cilët do të sigurohet siguri se në organizatë ekziston vetëdije, por edhe mënyra për t’u përgjigjur nevojave të punëtorëve dhe këshillim lidhur me ankesat.

4. Vlerat kulturologjike: Ky sipas gjithë rrethanave është parimi më i rëndësishëm dhe më i gjerë. Organizata ka mundësi t'i identifikoj kërkesat e mundshme nëse fokusohet në vlerat kulturologjike. Funksionimi elementar i organizatës mund të shihet nga aspekti i barazisë vetëm nëse kihen parasysh vlerat kulturologjike. Politikat, procedurat dhe programet edukative duhet të zhvillohen dhe zbatohen në një bazë të integruar e që së bashku me vlerësimin të kryhet promovim i qëndrimeve për barazi gjinore në vendin e punës. Çështjet e ndryshme në lidhje me barazinë gjinore duhet të shqyrtohen në konsultime të përbashkëta me të gjithë të punësuarit dhe të bëhet informimi për praktikën më të mirë. Një nga strategjitë mund të jetë edhe përfshirja e barazisë gjinore në kushtet e punës për kryerjen e kontrollit në organizatë.

5. Strategjitë: Katër fushat që janë përmendur më lartë paraqesin pika kryesore fokale që të shqyrtohet pjekuria në organizatë lidhur me çështjet gjinore. Në suazat e strategjive shtohet edhe elementi i pestë. Kjo përfshin obligimin e organizatës që të zhvillon njohuri dhe kuptim për atë si mund të ndryshohet sistemi që të përmbushen qëllimet për çështjet gjinore në tërësi. Në këtë mënyrë, anëtarët e organizatës përforcohen përmes njohjes së strategjive ekzistuese. Më pas, duhet të vendosen dhe vlerësohen programe të reja, me të cilat do të identifikohen dhe adresohen pabarazitë, nevojat e posaçme dhe statusi i grave në raport me punësimin në të gjithë nivelet.

6. LISTË KONTROLLI PËR PLANIFIKIM DHE ORGANIZIM

Zhvillimi i punës

Integrimi gjinor është çështje që paraqet sfidë të madhe dhe për këtë në fillim të punës duhet të karakterizohet me një zhvillim të kufizuar dhe më pas të ketë ndarje të qartë të përgjegjëseve, detyrave dhe roleve. Prej këtij, ekzistimi i një plani aksionar për punën praktike është më se e rëndësishme. Ky plan duhet të përgatitet me përdorimin e Listës së kontrollit për planifikim dhe organizim të punës. Më pas, i njëjti plan do të përcaktoj nivelin e qëllimeve dhe planeve për punë.

Rezultate të pritura

Puna me këtë model do të mundësojë:

- Kontroll çfarë duhet të bëjë organizata që ta organizoj punën rreth integrimit gjinor
- Pikëpamje për gjendjen momentale në organizatë dhe vetëdije për atë si mund të vazhdohet puna
- Bazë për planifikim në menaxhimin dhe organizimin e punës rreth integrimit gjinor.

Metoda

Këtu janë theksuar katër “faktorë strategjik për sukses” për integrimin gjinor:

- Qëllim dhe vëzhgim
- Trajnim
- Metoda dhe procedura
- Mbështetja dhe koordinim.

Ndryshimi sistematik gjatë punës ka rëndësi themelor kur organizata dëshiron të ndërtojë integrim afatgjatë gjinor në funksionimin e saj elementar. Qëllimi i këtij integrimi gjinor është që puna të jetë e barabartë në aspektin gjinor apo që të krijohen kushte që janë të barabarta për të dyja palët, që kanë cilësinë e njëjtë dhe që janë të ndara të gjithë qytetarët, pa marr parasysh gjininë e tyre. Që të arrihet kjo, **ne kryejmë analizë për barazi gjinore dhe përgatitim plan për atë se si të përmirësohet barazia gjinore në punë.**

Puna e këtillë imponon nevojën për organizim përkatës dhe qëllime të qarta për vet punën zhvillimore. Për këtë arsye, kjo detyrë konkrete ka vend qendror në listën tonë të kontrolleve të faktorëve të suksesit.

Lista e kontrolleve bazohet në përvojat tona e mëdha si nga puna e rregullt ashtu edhe nga përvojat për integrim gjinor në organizata, përfshirë edhe ministrinë.

Puna e institucioneve qeveritare bazohet në këto faktorë të suksesit dhe çdo faktor i suksesit ka qëllime shtesë, e të cilat më pas plotësohen me plane të përditësuara aksionare në nivel vjetor.

Pyetjet në listën për kontroll janë formuluar në atë mënyrë që mund të përdoren gjatë revidimit të barazisë gjinore dhe ato përqendrohen në atë se si mundet organizata të sigurojë se ka përmirësim në punën zhvillimore dhe se në këtë mënyrë kryhet ndikim i afatgjatë. Gjithashtu, këto çështje duhet të sigurojnë udhëheqës dhe inspirim edhe gjatë zhvillimit të fazës fillestare, kur veç më planifikohet dhe fillohet puna.

Faktorë të suksesit

Qëllimet dhe mbikëqyrja

Që të arrihet sukses në punë, kreu duhet qartë të informoj tërë organizatën për atë se çfarë ka vendosur dhe çfarë janë pritjet. Nëse aktivitetet e vazhdueshme merren si duhet, këto direktiva do të kuptohen seriozisht, sepse për pjesë të ndryshme të punës do të ketë nevojë të dorëzohen raporte.

Integrimi gjinor imponon nevojën për investim edhe atë të paktën gjatë fazës fillestare. Puna duhet të zhvillohet në mënyrë sistematike, nëse vet investimi duhet të jep rezultate në formë të aktiviteteve më efektive dhe më përkatëse. Prej këtui, resurset e ndara duhet të tregojnë nëse organizata konsideron se puna është e rëndësishme dhe se përfundimisht duhet kryer apo thjeshtë ajo kryhet vetëm për shkak se ekziston obligimi për këtë.

Trajnim

Trajnimi ka rëndësi esenciale për suksesin; dhe për këtë vet krerët dhe të punësuarit duhet të jenë të vetëdijshëm për teorinë e çështjeve gjinore dhe synimet e politikës qeveritare për barazinë gjinore. Kjo do t'i nxit që të shqyrtojnë synimin e integritit gjinor dhe do t'ua lehtësojë pranimin e metodave të reja për analizim të barazisë gjinore. Njerëzit kanë nevojë për njohuri të caktuara që të mund t'i kuptojnë dhe përdorin informacionet dhe analizat në mënyrën përkatëse.

Metoda dhe procedura

Për integrimin gjinor nevojitet qasje me punë sistematike, që nënkupton përdorim të vazhdueshëm të informacioneve statistikore të ndara sipas gjinisë, zbatimin e analizave për barazi gjinore çdoherë para se të merren vendime dhe analizim të proceseve të rëndësishme të punës në aspekt të barazisë gjinore. Të punësuarit patjetër të posedojnë metoda që janë të përshtatshme për punë nëse duan të punojnë në mënyrë efektive.

Mbështetje dhe koordinim

Për këtë proces nevojitet kuadër i cili do ta koordinoj punën në organizatë. Gjithashtu nevojitet mbështetja e organizatës, me çka punëtorëve do t'u sigurohet nxitje dhe këshilla për punë. Këmbimi i përvojave në mënyrë të organizuar mund ta lehtësojë punën. Krahas kësaj, patjetër duhet të ekzistojë koordinim në trajnimet dhe zhvillimin e metodave në suazat e agjencisë. Mundësi e njëjtë duhet t'u jepet të gjithëve që të kuptojnë çfarë ndodh ku përvoja e çdo individi është e rëndësishme për punë.

Zhvillimi strategjik paraqet çështje kyçe. Puna patjetër duhet të mbahet në suazat e organizatës edhe pas përfundimit të fazës së parë zhvillimore. Prej atje është e rëndësishme që të formohet platformë për zhvillimin e strategjisë për integrim gjinor në vet organizatën. Strategjia patjetër duhet të jetë një hap më përpara nga organizata dhe të ofroj propozime për përmirësimet, që mund të aplikohen në punën e përditshme.

Lista e kontrollit për planifikim dhe organizim të punës zhvillimore

Detyra të përgjithshme

- Në çfarë mënyre udhëheqësia e ka treguar qartë obligimin e vet për zhvillimin dhe zbatimin e integritit gjinor?
- Cilët aktivitete konkrete i ka ndërmarrë udhëheqësia e lartë që të informoj për punën rreth integritit gjinor dhe më pas të sigurohet se të punësuarit në kompani e kanë kuptuar këtë?
- Në çfarë mënyre është përgjegjëse udhëheqësia në raport me aktivitetet rrjedhëse dhe zhvillimin e punës?
- Kush nga udhëheqësia e lartë është përgjegjës për aktivitetet rrjedhëse dhe zhvillimin e punës?

Qëllimet, kontrollet dhe shqyrtimet

- Çfarë drejtime/ direktive janë dhënë në organizatë lidhur me integrimin gjinor?
- Si kryhet zbatimi i përpiktë i aktiviteteve të vazhdueshme për qëllimet e integritit gjinor në agjenci?
- Çfarë ndërmerret në agjencinë që të kryhet vlerësim dhe të përmirësohet çështja rreth integritit gjinor?
- Nëse resurset e ndara (kohë dhe para) janë përkatëse me punën konkrete?
- Si bëhet informimi për planin aksionar për integrimin gjinor në tërë organizatën dhe në çfarë mënyra kërkohet dhe sigurohet mbështetja?

Trajnimi

- A ekziston plan për kualifikime të cilat duhet t'i posedoj kuadri i cili do ta kryej punën e caktuar?
- A ekziston plan se si organizata do të dijë se udhëheqësia dhe të punësuarit posedojnë njohuritë e mjaftueshme për ta kryer punën e caktuar?
- Si do të sigurohet ndihma ndaj të punësuarve për ta zbatuar diturinë e tyre?
- A ekziston plan afatgjatë për atë se si mundet organizata të siguroj diturinë dhe shkathtësitë e nevojshme për zhvillim të mëtutjeshëm?

Metoda dhe procedura

- Cilat metoda dhe procedura tjera do t'i zbatoj organizata për t'i arritur synimet dhe rezultatet e pritura?
- Si përdoren përvojat e mëhershme nga puna e barazisë gjinore?
- Si përdoret statistika e të dhënave të ndara nëpër gjinitë gjatë punës?

Mbështetje dhe koordinim

Funksioni i koordinimit

- Si koordinohet puna e integritit gjinor në suazat e organizatës?

Organizimi i mbështetjes

- Si të përmbushen nevojat për mbështetje, këshilla dhe nxitje?
- Si është organizuar këmbimi i përvojave?

Zhvillimi strategjik

- Cila është mënyra më e mirë që të vazhdohet më tutje dhe të sigurohet se strategjia e organizatës për integritim gjinor vazhdoj të zhvillohet?

7. METODA PËR ZBATIMIN E ANALIZËS SISTEMATIKE PËR BARAZINË GJINORE GJATË PUNËS

Kjo metodë është e ndarë në pjesë të ndryshme: regjistrim, vendosje të prioriteteve, hulumtim, analizë, masa dhe vlerësim.


Kjo metodë është zhvilluar gjatë punës praktike në institucionet qeveritare. Ky version është përpunuar për t'ju përshtatur agjencive qeveritare e më pa është testuar hollësisht.

Rezultatet e pritura


Puna me *Metodën për zbatimin e analizës sistematike për barazinë gjinore gjatë punës* (modeli *JamKAS Bas*) siguron:

- analiza e punës në bazë të argumenteve për barazi gjinore
- bazë që të përzgjidhet fusha më relevante ku do të punohet
- ndihmë gjatë përgatitjes së masave dhe treguesve me të cilat do të matet barazia më e madhe gjinore


PËRGATITJA E LISTËS/REGJISTRIMIT



HULUMTIM DHE ANALIZË



FORMULIMI OBJEKTIVAVE



Përgatitje e regjistrimit/listës

Hapat 1-3 në *JamKAS Bas* përfshijnë përgatitjen e regjistrimit/listës për funksionimin dhe diskutimin për atë se si mund të ndihmohet që të arrihen qëllimet e politikës për barazi gjinore. Më pas, bëhet përzgjedhja e fushave që kanë rëndësi strategjike për barazinë gjinore. Më a mund të vazhdoni me analizën në këtë fushë. Analiza fokusohet në integrimin gjinor në aktivitetet që kanë ndërlidhje me resurset njerëzore apo diçka që është e lidhur me Ligjin për mundësi të barabartë (barazi “e brendshme” gjinore)

Hapi 1 Cilët aktivitete?

Përmendi aktivitetet e agjencisë/repartit. Që ta kufizoni punën, zgjidhni një pjesë të aktivitetit për analizë më të detajuar në Hapin 3.

Hapi 2. Si mund të ndikoj aktiviteti ndaj politikës së barazisë gjinore?

Shikoni nëse aktivitetet e juaja ndikojnë në barazinë gjinore dhe më pas përgjigjuni në pyetjet e mëposhtme. Pyetjet kanë të bëjnë me qëllimet e barazisë gjinore. Ato janë të rëndësishëm sepse e lehtësojnë punën e analizës së mëvonshme dhe për këtë ju këshillojmë të ndani kohë dhe të përgjigjeni. Parashtroni pyetje për çdo pjesë të aktivitetit.

Qëllimi i primar 1. Ndarje e barabartë e fuqisë dhe ndikimeve mes grave dhe burrave.

- Gratë dhe burrat kanë të drejtat dhe mundësitë e njëjta që të jenë qytetarë aktiv dhe t'i sjellin kushtet për vendimarrje.

Diskutoni:

1. A ndikon ajo që e punojmë ndaj mundësive të grave dhe burrave? Si?
2. A ndikon ajo që e bëjmë ndaj ndarjes së fuqisë mes grave dhe burrave? Si?
3. A ndikoj ajo që e bëjmë në aftësinë e burrave dhe grave për ta praktikuar fuqinë e tyre dhe të kenë ndikim? Si?

Qëllimi i përkohshëm 2. Barazia ekonomike mes burrave dhe grave

- Gratë dhe burrat kanë mundësi dhe kushte të barabartë në arsim, trajnim dhe punë të gabuar që mundëson pavarësi të përgjeshme ekonomike.

Diskutoni:

1. A ndikoj kjo që e bëjmë ndaj gjendjes financiare të grave dhe burrave? Si?
2. A ndikoj kjo që e bëjmë ndaj mundësive dhe kushteve për punë të paguar, arsim dhe veprim sipërmarrës tek burrat dhe gratë? Si?

Qëllimi i përkohshëm 3. Ndarje e barabartë e kujdesit të papaguar dhe punës në amvisëri

- Burrat dhe gratë kanë përgjegjësi të njëjtë për punën në amvisëri dhe kanë mundësi të njëjtë të japin dhe pranojnë kujdes nën kushte të njëjtë.

Diskutoni:

1. A ndikoj kjo që e bëjmë ndaj mundësive të burrave dhe grave që të marrin pjesë në punë të papaguar në amvisëri? Si?
2. A ndikoj kjo që e bëjmë ndaj mundësive të burrave dhe grave që të marrin pjesë në punë të papaguar për mbajtje të kujdesit? Si ?

Qëllimi i përkohshëm 4. Dhuna e burrave ndaj grave patjetër duhet të ndërpritet

- Gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, kanë të drejta të njëjta në raport me integritetin fizik.

Diskutoni:

1. A ndikon ajo që bëjmë në dhunën e burrave ndaj grave? Si
2. A ndikon aktiviteti ndaj të së drejtës së grave dhe burrave, vajzave dhe djemve për integrimin e tyre fizik? Si?
3. A ndikon aktiviteti, ose a ka potencial që të ndikoj në dhënien e dimensionit gjinor në hapësirën publike në drejtim pozitiv apo negativ? Si?

Hapi 3. Çfarë duhet të analizohet?

Përmendni argumentet për dhe kundër përzgjedhjes së pjesëve të ndryshme të aktivitetit për analizë më të thellë. Zgjidhni ndonjë aktivitet (apo pjesë të aktivitetit) që ka rëndësi strategjike nga aspekti i barazisë gjinore. Përmendi arsyet e përzgjedhjes suaj.

Diskutoni cili aktivitet, apo pjesë e aktivitetit, ka rëndësi më të madhe strategjike nga aspekti i barazisë gjinore. Në arsye mund të përfshihet:

- se mund të keni ndikim dhe kontroll ndaj masave
- se me to bëhet ndikimi ndaj shumë njerëzve
- se kjo çështje për momentin është lëndë e debatit politik
- se aktiviteti për momentin e nxit këtë pabarazi.

Bëni listë të të gjithë argumenteve për dhe kundër gjatë përzgjedhjes së alternativave të ndryshme të aktiviteteve. Kjo do të lehtësojë përzgjedhjen e juaj strategjike. Për momentin organizata vendos se cila fushë duhet të analizohet rrënjësisht dhe përgatit orar për punën.

Hulumtim

Hapat 4-6 japin përshkrim se si duhet të zbatohet një hulumtim më i thellë për aktivitetin e zgjedhur dhe më pas të analizohen faktet e fituara. Qëllimi është që të shkohet më tutje, që të mendohet në mënyrë kreative dhe më pas të bëhet përpjekje kjo çështje të shqyrtohet nga aspekti i gjendjes dhe nevojave të grave dhe burrave.

Hapi 4. Identifikimi i grupit të caktuar

Identifikoni grupin e caktuar për aktivitetin që e keni zgjedhur. “Grup i caktuar” nënkupton njerëzit kujt i dedikohet aktivitetit dhe për të cilët janë planifikuar resurset. Këtu nuk bëhet fjalë për atë kush punon në këtë çështje. Për shembull, në një projekt për të rinj, grupi i caktuar janë të rinjtë, dhe pikërisht duhet të ndryshohet bota e tyre. Shumë aktorë punojnë në çështjet e të rinjve, përfshirë këtu edhe nëpunësit e komunave, por këto nëpunës paraqesin vegël përmes të cilës do të arrihet deri tek rinjtë ndërsa ato vetvetiu nuk paraqesin grup të caktuar. Ato mund të jenë aktorë, por jo edhe grup caku.

Hapi 5. Cilët formular gjinor janë prezent këtu?

Bëni listë të pyetjeve dhe deklaratave për gjendjen e grave dhe burrave ndërsa përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të jenë të dobishme gjatë vlerësimit të aktivitetit. Shfrytëzoni shpjegimet që përmenden në teorinë e sistemit për çështje gjinore. Mendoni, në kontekst sa më të gjerë të mundshëm, për formularët gjinor që janë relevant në suazat e aktivitetit që duhet analizuar. Për momentin, mos kërkonin nëpër sirtarët me libra që të gjeni studime të mëhershme apo të dhëna ekzistuese statistikore.

Kjo për shkakun se faktet me të cilat posedoni për çështje të caktuar dhe formularët gjinor, mund të mos jenë më relevantë në rastin konkret. Cilët janë formularët momental gjinor mes vajzave dhe grave si dhe ndaj djemve dhe burrave?

Vendosni për cilat pyetje do t’u nevojitet përgjigja, nëse dëshironi t’i përcaktoni formularët gjinor. Mund të jetë më lehtë të punoni me supozim të caktuar në raport me situatën. Shfrytëzoni materialet nga Hapi 2.

- A ka diçka në aktivitet që krijon ndarje mes burrave dhe grave, dhe për këtë arsye ato ndodhen në fusha të ndryshme? Parashtroni pyetjen pa e shqyrtuar a është kjo e mirë apo e keqe. Si shprehet kjo ndarje në vet aktivitetin?
- Ku paraqiten gratë dhe burrave, vajzat dhe djemtë, jo vetëm si qytetarë dhe konsumatorë, por edhe si bartës të vendimeve?
- A ka dallim mes gjinive në fushat relevante në raport me kushtet e jetës, mirëmbajtjen, të drejtave, fuqinë, resurset, sigurinë etj?
- Shqyrtoni si paraqiten gjinitë dhe si kryhet ndarja e resurseve. Mund të jetë e dobishme nëse mendoni për fuqinë formale dhe joformale. Cilët janë strukturat?
- A ka diçka në aktivitet që shkakton hierarki mes asaj që konsiderohet si “femërore” dhe “burrërore” dhe që i jep vlerë të madhe asaj “burrërore”? Për shembull, si manifestohet kjo gjatë shpërndarjes së resurseve, siç janë mjetet financiar dhe koha? A ka shembuj ku burrat paraqesin norma ndërsa gratë janë “anash”?

Hapi 6. Si është gjendja momentale?

Përshkruani formularët gjinor nga Hapi 5. Konfirmoni këtë me të dhëna kualitative dhe kuantitative.

Tani është koha që të fillohet me shqyrtimin e fakteve. Si është gjendja momentale? Disa të dhëna mund t’i keni në dispozicion nga hulumtimet dhe studimet e mëhershme. Disa informacione tjera mund t’i keni në

dispozicion nga statistika zyrtare apo publikime tjera. Ndoshta, për momentin edhe nuk ka informacione në dispozicion dhe në këtë rast mund të propozoni që të detektohet kjo mungesë tek ata që e përpilojnë këtë statistikë. Pas kësaj mund të formuloni detyrë: është e nevojshme që të përgatitim statistikë të re. Është shumë e rëndësishme që të shqyrtohet se si resurset (si koha, mjetet financiare, informacionet dhe trajnimi) në suazat e aktivitetit ndahen mes grave dhe burrave dhe si bëhet ndarja gjinore në qarqet formale dhe joformale dhe rrjetat që janë bartës të vendimeve.

Analizë

Në hapat 7-9, analizoni statistikën dhe faktet që i keni grumbulluar dhe shqyrtoni se çfarë mund të bëhet rreth pamjes së gjendjes që del prej tyre. A sigurohen për burrat dhe gratë të drejtat, obligime dhe mundësitë e njëjta duke shtuar aktivitet të caktuar? Nëse jo, cilët janë pasojat dhe çfarë mund të bëhet në këtë drejtim?

Hapi 7. Cilët janë pasojat?

Nëse ka diçka që tregon për mungesë të barazisë gjinore në Hapin 6, përshkruani pasojat e mundshme.

Filloni me formularët gjinor që u paraqitën në Hapat 2 dhe 6. Përshkruani si ndikojnë ato tek vajzat dhe gratë si dhe tek djemtë dhe burrat. Përshkruani si manifestohet kjo mungesë e barazisë gjinor. Shpesh gratë dhe burrat kanë të drejta dhe obligime të njëjtë, por jo edhe mundësi të njëjtë, nëse kjo është kështu, përshkruani pasojat. Për shembull, kjo mund të lidhet me mundësinë që të kihet një e drejtë e caktuar.

Hapi 8. Si të kontribuohet drejt qëllimeve për barazi gjinore?

Përshkruani si duhet të dizajnohet aktiviteti që të ndihmohet të realizohen qëllime të ndryshme për barazinë gjinore.

Përshkruani një aktivitet ideal nga aspekti i barazisë gjinore. Shfrytëzoni të dhënat nga Hapi 2. Përsëri përpunoni qëllimet e përkohshme dhe parashtroni pyetjen “Si duhet të dizajnohet aktiviteti që të ndihmohet rreth realizimit të këtij qëllimi të përkohshëm?”

Hapi 9. Çfarë mund të bëhet?

Përmendni shembujt që mund të rritin barazinë gjinore. Bëni listë të propozimeve që mund të përmirësojnë situatën. Këto propozime mund të jenë ose në fusha për të cilat keni mandat për ndryshim ose në fusha që janë nën kontrollin e tjerëve. Bëni skicë, duke filluar nga formularët që i keni zbuluar. Me siguri, në propozimet e ndryshme do të ketë synime kundërtëse. Sqaroni dhe përshkruani ato. Tregoni cilët janë argumentet për dhe kundër propozimeve të ndryshme. Organizata vendos si do të vazhdoni më tutje apo cili do të jetë zhvillimi i aktivitetit në fazën e ardhshme.

Për shembull

Analiza tregon se gratë më shumë përdorin transportin publik dhe se gjatë kthimit në shtëpi ndalen më shumë se burrat. Tek burrat probabiliteti është më i madh që ata nga puna me makinë të udhëtojnë direkt në shtëpi. Nëse e marrim parasysh destinacionin e dhënë, cilat masa do ta rritin apo pengojnë barazinë gjinore? Për këtë ekzistojnë më shumë opsione. Mund të propozoni që të rritet transporti publik që t’u lehtësohet gjendja grave apo të kërkoni ridestininim të trafikut të autobusëve dhe miratimin e linjave të reja të autobusëve në kohën kur burrat shërbehen me makina.

Disa çështje tjera më voluminoze që mund të jenë në interes të këtij diskutimi janë financimi më i madh i transportit publik nga tatimet, pikat pagesore dhe niveli i tatimit për shfrytëzimin e rrugëve. Si ndikon ky lloj i masës së formularëve gjinorë konkretisht për udhëtim? Dhe si ndikojnë formularët e tjerë të përgjithshëm që të mbahen shprehitë e ndryshme për udhëtim tek grave dhe burrat?

Masa

Hapat 10-11 përfshijnë gjetjen e masave me të cilat do të ndryshojë rezultati në aspekt të barazisë gjinore. Më pas duhet t’i zgjidhni masat dhe të ndërmerreni aktivitete të vazhdueshme, nëse duhet të bëhet vlerësimi i rezultateve. Çfarë do të ndryshoni? Si do t’i matni ndryshimet?

Hapi 10. Cilat masa duhet të ndërmerren?

Vendosni cilat masa nga Hapi 8 doni t’i zbatoni. Bëni plan si dhe kur ato do të zbatohen. Ndani kohë dhe resurse. Bëni plan për trajnim. Bëni shqyrtim të propozimeve për aksion të mundshëm në Hapin 9. Zgjidhni cilët masa duhet të zbatohen që të rritet barazia gjinore. Bëni plan si do të zbatohen ato. A ka organizata në dispozicion kohë, dituri dhe shkathtësi dhe gjithashtu a duhet të planifikoni trajnim?

Hapi 11. Si do të matet rezultati?

Vendosni cilët do të jenë aktivitetit e vazhdueshme për masat dhe ndikimet. Si mund t'i ndiqni masat dhe ndikimin e tyre? Si do ta matni rezultatin? Si e shfrytëzoni përvojën e fituar dhe si i vendosni leksionet e mësuara në punën e juaj të rregullt? Të dhënat statistikore të ndara sipas seksit/gjinisë paraqesin një prej mënyrave për matjen dhe ndjekjen e rezultateve.

8. BUXHETIM I PËRGJEGJSHËM GJINOR

Pse buxhetimi përgjegjës gjinor është çështje e mundësive të barabartë të grave dhe burrave?

Çështja e barazisë dhe përfshirjen e perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore, është çështje e rëndësishme në sigurimin e mundësive të barabartë dhe jetë cilësore për të gjithë. Prej këtui, arritja e barazisë gjinore dhe menaxhimi me pabarazitë e vazhdueshme, shpesh nënkupton të punohet ndryshme me gratë dhe burrat, pas çka duhet të detektohen pengesat e ndryshme me të cilat ata ballafaqohen, por edhe nevojat dhe prioritetet e ndryshme që ato i kanë.

Zbatimi i analizimit të politikave dhe buxheteve nga aspekti gjinor, kreatorëve të politikave në nivel nacional dhe lokal iu jep një vegël të re që mund të përdoret që në procesin e planifikimit. Këto analiza ndihmojmë që t'i shohim efektet dhe pasojat dhe të theksojmë se implikimet nga politikat dhe programet që zbatohen, janë të ndryshme për grupet të ndryshme.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) mundëson gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave, të kihet parasysh pozita e ndryshme e grave dhe burrave dhe pengesat e ndryshme që pamundësojnë që tërësisht dhe me kushte të njëjtë të marrin pjesë në të gjithë sferat e jetës shoqërore. Kjo mundëson që politikat të drejtohen drejt shfrytëzuesve konkret dhe nevojave të tyre, me çka do të krijohen programe më efikase ndërsa mjetet publike do të shpenzohen në mënyrë më të drejtë. Buxhetet dhe politikat/programet në nivel nacional dhe lokal duhet të aftësohen drejt nevojave reale të grave dhe burrave, me çka do të avancohet barazia gjinore në shoqëri.

Qasja në çështje

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i Qeverisë, me qëllim që t'iu përgjigjet nevojave të grupeve të ndryshme. Në këtë drejtim, buxheti paraqet vendim politik si dhe vend kyç për marrjen e informacioneve për atë se sa janë mjetet qeveritare/komunale për vitin e ardhshëm, prej ku fitohen dhe si shpërndahen. Në fakt, nëse e shohim për shembull buxhetin e një komune, ne nuk kemi njohuri vetëm në bilancin mes shpenzimeve dhe të ardhurave, por e shohim edhe vet procesin e prioriteteve të vendosura dhe marrjen e vendimeve për çështje që ndikojnë ndaj situatës aktuale dhe të ardhshme të njerëzve dhe rrethit të tyre. Në këtë drejtim, vendimeve qeveritare/komunale në lidhje me buxhetin ndikojnë në jetën tonë të përditshme dhe ardhmërinë tonë: çfarë transporti do të shfrytëzojmë, çfarë arsimit do të kenë fëmijët tanë, çfarë kujdesi shëndetësorë do të jemi, ndikon në sigurinë tonë personale, se çfarë shërbime do të kemi në këtë drejtim e kështu me radhë. Për këtë themi se buxhetet publike nuk janë thjeshtë vegël ekonomike, por ato bëjnë përmbledhje të politikave publike (të qeverisë apo vetëqeverisjes lokale) në terme monetare dhe i shprehin **prioritetet** e tyre. Prej këtui, buxhetet nuk janë neutral në aspektin gjinor. Pa marrë parasysh a bëhet fjalë për bujqësi, shëndetësi, arsim apo politikë sociale, s'mund të injorohet çështja e efekteve të këtyre politikave për burrat dhe gratë, nën petkun e barazisë apo ndarjes së barabartë për të gjithë. Duhet të theksohet se buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk nënkupton buxhet të veçantë për gratë e as nuk nënkupton ndarje të buxhetit për 50% për gratë dhe gjysma tjetër për burrat. Përkundrazi, buxhetimi gjinor është proces përmes të cilit shqyrtohen buxhetet publike me qëllim që të vlerësohet nëse dhe sa kontribuojnë për barazi mes burrave dhe grave e me këtë të propozojnë ndryshime në drejtim të arritjes së barazisë gjinore.

Situata në Republikën e Maqedonisë

Përpjekjet shumëvjeçare që të gjenden mënyrat më efikase përmes të cilave përcaktimet politike për barazi gjinore që përmenden në legjislacionin nacional dhe dokumentet ndërkombëtare, kanë treguar se këto insistimet mund të zbatohen vetëm nëse parimi i barazisë gjinore në mënyrë përkatëse integrohet në të gjitha politikave publike dhe nëse shoqëria në përgjithësi merr përgjegjësinë për realizimin e barazisë gjinore. Një prej këtyre metodave për realizimin e këtij synimi është edhe buxhetimi i përgjegjshëm, që edhe pse paraqet risi, po bëhet praktikë e përhapur si në nivel global ashtu edhe tek ne.

Ligji për mundësi të barabartë të grave dhe burrave³ rregullon vendosjen e mundësive të barabartë dhe trajtimin e njëjtë të grave dhe burrave, në fushën politike, ekonomike, sociale, arsimore, kulturore, shëndetësore dhe civile. Në Ligj theksohet se vendosja e mundësive të barabartë është kujdes i tërë shoqërisë gjegjësisht të subjekteve në sektorin publik dhe privat, pas çka kjo paraqet largimin e pengesave dhe krijimin e kushteve për realizimin e barazisë së plotë mes grave dhe burrave. Me definimin e kompetencave të subjekteve përgjegjëse, në Ligj jepet baza juridike për miratimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Qeveria e R. së Maqedonisë në qershor të vitit 2012-të, miratoi Strategjinë për buxhetim të përgjegjshëm gjinor⁴ (SBPGJ) si dokument nacional me të cilin synohet avancimi i barazisë gjinore dhe vendosja e mundësive të barabartë të grave dhe burrave, përmes aftësimit të proceseve ekzistuese të planifikimit dhe buxhetimit të politikave dhe programeve të shfrytëzuesve buxhetor, duke i pasur parasysh implikimet e ndryshme ndaj grave dhe burrave. Miratimi i perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel nacional dhe lokal, duhet të çoj deri në ndarje të drejtë dhe gjinore të mjeteve si dhe transparencë më të madhe si dhe përgjegjësi të buxhetit shtetërorë nga aspekti i barazisë gjinore.⁵

SBPGJ fokusohet në tre fusha strategjike që kanë të bëjnë në mënyrë të barabartë me ministrinë resor, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit: 1) aplikimin e perspektivës gjinore në programet dhe shfrytëzuesve buxhetore në nivel qendror dhe lokal, 2) avancimi i kornizës ligjore për përfshirje të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe 3) përforcimi i mekanizmave institucional dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për përfshirjen e perspektivës gjinore në krijimin e politikave dhe programeve dhe buxheteve përkatëse⁶.

Zgjidhje- Komuna juaj mund të ndihmoj shumë

Aktorë në procesin e buxhetimit të përgjegjshëm janë të njëjtit ato që direkt apo indirekt janë të përfshirë në procesin e miratimit të buxhetit dhe planeve strategjike. Kjo nënkupton se miratimi i buxhetit dhe buxheti gjinor do të thotë proces i njëjtë, por me një qasje tjetër gjatë vendosjes së prioritetëve, programeve dhe indikatorëve⁷.

Kjo është shumë e rëndësishme për njësitë e vetëqeverisjes lokale sepse ato janë më afër qytetarëve. Zbatimi i BPGJ do t'u mundësojë që t'i identifikojnë problemet e ndryshme me të cilat ballafaqohen gratë dhe burrat e që dalin nga nevojat e tyre të ndryshme. Në këtë mënyrë vetëqeverisja lokale do të jetë në mundësi këto prioritetet t'i reflektoj në programet lokale, të përcjella me indikator përkatës që do ta matin suksesin dhe do të identifikojnë drejtime për veprim të mëtutjeshëm. Prej këtui, pjesëmarrës primar në buxhetim të përgjegjshëm gjinor në nivel lokal janë

- Kryetarët e komunave që duhet të angazhohen për inkorporimin e konceptit gjinor gjatë përgatitjes së buxhetit për njësinë e vetëqeverisjes lokale. Kjo do të thotë se ata duhet të ndikojnë dhe të kërkojnë gjatë identifikimit të prioritetëve të merren parasysh nevojat dhe prioritetet e ndryshme të burrave dhe grave, më tej, që të njëjtit të propozojnë aksione përkatëse gjatë përgatitjes së programeve në komunën e tyre dhe për ta të sigurojnë mjete buxhetore.
- Këshilltarët në Këshillin e vetëqeverisjes lokale, duhet të dinë të njohin dhe inkorporojnë aspektin

3 Shembulli 1: Për shkak të dallimeve të vazhdueshme tek rrogat e grave dhe burrave, përqindja më e vogël e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe përqindja më e madhe e grave në vende ku rroga është e vogël, gratë mesatarisht kanë të ardhura më të vogla se burrat. Si pasojë, më shumë burra do të kenë dobi nga implementimi i tatimit të barabartë ndërsa më shumë gra do të kenë dobi nga rritja e pagës minimale.

Shembulli 2: Hulimtimi tregon se gratë më shumë e shfrytëzojnë transportin publik për kryerjen e punëve familjare, të punës dhe obligimet sociale (standard më të ulët dhe lidhjet tradicionale). Kështu, në ulen investimet në transportin publik, kjo do të ketë ndikim më të madh negativ ndaj cilësisë së jetës së grave sa të burrave

Ligji për mundësi të barabartë të grave dhe burrave (Gazeta zyrtare e RM, nr.6/2012)

4 Strategjia për implementimin e buxhetimit të përgjegjshëm në R. e Maqedonisë 2012-2017, Ministria e punës dhe politikës sociale, qershor, 2012

5 Ibidem

6 Ibidem

7 Doracak për buxhetim të përgjegjshëm gjinor për administratën e R. së Maqedonisë, 2012

gjinor në politikat buxhetore në vetëqeverisjen lokale në fazën e përgatitjes së buxhetit të komunës dhe gjatë seancave të komisioneve të Këshillit të mbrojnë konceptin dhe të angazhohen perspektiva gjinore të jetë pjesë e buxhetit që do të dorëzohet për miratim.

- Koordinatorët për mundësi të barabartë të burrave dhe grave, që me profesionalizmin e tyre nga fusha e mundësive të barabartë duhet t'u ofrojnë drejtime dhe të ndihmojnë në procesin e përgatitjes së politikave, programeve dhe buxheteve. Nëse ju hedhim një sy zgjidhjeve ligjore dhe politikave që kanë të bëjnë me decentralizimin e ingerencave të tyre bëhet e qartë se ekziston qëllim pozitiv që të njëjtit të krijohen dhe fokusohen në plotësimin e nevojave të popullatës lokale. Pushteti lokal ka më shumë mundësi që t'u përgjigjet specifikimeve të zhvillimit lokal si dhe të mundësojë pjesëmarrje të qytetarëve në proceset lokale. Për këtë, komuna duhet të jep përpjekje maksimale për ndarjen e prioriteteve të qytetarëve përmes praktikimit të proceseve pjesëmarrëse gjatë vendosjes së prioriteteve në fushat ku ka kompetenca (hulumtim, anketa, tubimin e qytetarëve, forume dhe vegla tjera) si dhe përfshirjen e konceptit gjinor gjatë krijimit dhe implementimit të vet politikave. Më tej, decentralizimi del nga fakti se nevojat lokale të qytetarëve dallojnë në çdo komunë, për shkak të dallimeve demografike, ekonomike e tjera dhe nevojave specifike të qytetarëve. Për krijimin e programeve për nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve, komunat duhet të fillojnë me përpunimin e profilit të komunitetit, përmes analizës së të gjithë informacioneve relevante, ndërsa më tej, si hap i dytë të institucionalizohen dhe rregullisht të praktikohen forma të pjesëmarrjes civile, ku edhe gratë edhe burrat do t'i tregojnë problemet dhe prioritetet e tyre. Nga ana tjetër, nevojitet përforsim i mëtutjeshëm i kapaciteteve në njësitë e vetëqeverisjes lokale që të njëjtit në suazat e planeve dhe buxheteve të tyre strategjike, të inkorporojnë parimin e mundësive të njëjtë për gratë dhe burrat si dhe t'i ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre ndaj grave dhe burrave, që në fakt është obligim i tyre ligjor para Ligjor për mundësi të barabartë.

Vullneti politik është një prej faktorëve kyç për implementimin e konceptit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor qoftë në nivel nacional apo në atë lokal. Madje edhe kur këto aktivitete parashihen, të njëjtat kuptohet nuk mund të realizohen pa mbështetjen e liderëve. Faktori i dytë kyç është ekzistimi i të dhënave të ndara gjinore. Ekzistimi i të dhënave të ndara gjinore statistikore si dhe parametrat tjerë do të mundësojë sigurimin e indikatorëve në bazë të së cilëve do të mund të matej veprimi dhe efikasiteti i politikës. E gjithë kjo është e rëndësishme nëse në të vërtetë vlerësohen nevojat e komunitetit dhe resurset drejtohen për nevojat e vërteta të banorëve, që të shpeshtën dallojnë, e që reflektohet edhe në prioritetet e tyre të ndryshme.

Një prej detyrave elementare të Komisioneve për mundësi të barabartë është promovimi dhe mbështetja e aktiviteteve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore në nivel lokal. Për realizim e kësaj detyra, KMB mund të punoj në mënyrë individuale, por nevojitet bashkëpunim me komisione tjera dhe këmbim mendimesh në fazën e përgatitjes së programeve dhe buxheteve në sfera të ndryshme.

PËRFSHIRJA E ASPEKTEVE GJINORE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE LOKALE

Përfshirja e aspekteve gjinore në krijimin e politikave lokale (gender mainstreaming) nënkupton (ri)organizimin, avancimin, zhvillimin dhe vlerësimin e proceseve politike, me qëllim perspektiva e barazisë gjinore të përfshihet në të gjitha politikat, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga vepruesit të cilët zakonisht janë të përfshirë në krijimin e politikave.

Vetë qasja do të thotë planifikim të intervenimeve zhvillimore duke marrë parasysh implikimet në bazë të dallimeve gjinore; ka për qëllim të zvogëlojë mospërputhjen gjinore dhe ta fuqizojë barazinë.

Për këto arsye, aspektet gjinore duhet të integrohen në:

- Politikat, planet dhe programet kombëtare
- Iniciativat zhvillimore ndërkombëtare
- Në gjithë sektorët dhe në të gjitha nivelet (strategji, politika, institucione dhe projekte).

Korniza e aftësive politike do të na ndihmonte që menjëherë t'i mësojmë të gjitha hapat që mund t'i ndërmarrin në drejtim të integrimit të aspekteve gjinore në politikat lokale. Mes tjerash, ajo do të na ndihmojë që:

- Të jemi sistematike, të vetëdijshme për nga strategjia, si dhe proaktive në planifikimin e tërë procesit – nga ideja e deri në zbatim
- Të kontrollojmë mos vallë kemi bërë ndonjë lëshim në cilëndo fazë të procesit e sidomos në drejtim të burrave dhe grave në procesin e analizës
- Më mirë të identifikojmë, ndjekim dhe vlerësojmë se cilat faza ecin mirë, dhe cilat më pak mirë në zbatimin e politikave
- T'u sqarojmë palëve të interesuara, këshilltarëve, shoqatave të qytetarëve dhe mediave se përse çështjet e barazisë duhet qenë pjesë integrale të procesit të krijimit të politikave
- Të kemi një debat të argumentuar rreth asaj që e kërkojmë.

Janë të vogla gjasat se zhvillimi i cilësdo politike do të jetë një proces i lehtë, e sidomos integrimi i çështjeve gjinore në këtë segment dhe kalimi nga njëra fazë në tjetrën, pasi politika në jetën reale është pothuajse çdoherë dinamike. Megjithatë, ekzistimi i kornizës si instrument do të na ndihmojë që ta “shpërthejmë” ndërlikueshmërinë e jetës reale, të bëhemi më të vetëdijshëm mbi aspektet strategjike dhe mbi pasqyrën më të gjerë, si dhe të hartojmë një politikë të mirë sensitive ndaj gjinisë.



PESË HAPAT DREJT KRIJIMIT TË POLITIKAVE DHE BUXHETEVE TË ORIENTUARA DREJT GJINISË

Njëra nga qasjet më të njohura dhe më shpesh të përdorura për analizimin e politikave kombëtare dhe ato lokale është qasja e Diana Elson, në pesë hapa. Ndjekja e këtyre hapave në drejtim të hartimit të politikave kombëtare dhe lokale në proceset e definuara me Kornizën e Politikave, mundëson integrimin e çështjeve gjinore dhe politikave më të përshtatura sipas nevojave të qytetarëve.



QASJA ME PESË HAPA:

1. Analiza e gjendjeve në lidhje me gratë dhe burrat në sektorin në fjalë

- A janë aspektet gjinore pjesë të analizës së gjendjeve?
- A jep analiza e gjendjeve një pasqyrim të të dhënave statistikore mbi çështjet gjinore?
- Kush janë problemet specifike në sektor?
- Ku identifikohen pabarazitë gjinore në sektor?
- Cila është arsyeja për këto pabarazi?
- Kush janë vështirësitë dhe problemet në sigurimin e barazisë gjinore në sektorin i cili është lëndë e analizës?
- Cilat janë ndërlikimet që janë rezultat të pabarazive gjinore në sektor?

2. Analiza e politikës dhe ndjeshmëria e saj ndaj çështjeve gjinore

- A janë nevojat dhe interesat e burrave dhe grave, përfshirë këtu dhe problemet me të cilat po përballen ata po trajtohen barabartë në politikën, strategjinë ose programet e institucionit?
- Kush do të ketë dobi nga këto politika, strategji dhe programe dhe në çfarë mënyre?
- Kush janë problemet me të cilat po përballen gratë dhe burrat për të vlerësuar dobinë nga këto programe?
- Çfarë ndryshimesh mund të propozojnë gjatë programeve rrjedhëse për ta përmirësuar gjendjen e kategorive të caktuara të grupeve?
- Në çfarë mase objektivat e politikave dhe programeve në një sektor të caktuar korrespondojnë me problemet e përcaktuar?

2. Analiza e politikës dhe ndjeshmëria e saj ndaj çështjeve gjinore

- Çfarë intervenime po ndërmerren për të tejkaluar këto probleme?
- Ata që ndërmarrin këto intervenime, a i kuptojnë pabarazitë gjinore dhe janë të senzibilizuar ndaj këtyre çështjeve?
- Nëse gjatë zbatimit të politikave dhe programeve është përfshirë një teknologji e re, a do ta rrisë kjo gjë barrën e grave, apo do ta lehtësojë atë?
- A nevojitet trajnimi plotësues?
- A nevojiten veprime afirmative të cilat do të sigurojnë përfitime të barabarta edhe për gratë?

3. Analiza e shpërndarjes së buxhetit

- Shpenzimet specifike të menduara për gra. Këto shpenzime në mënyrë specifike janë orientuar drejt një grupi të caktuar qëllimor (burra, gra, etj.)
- Shpenzimet e menduara për promovimin e barazisë gjinore në shërbimet publike: përfaqësimi i barabartë i burrave dhe grave në strukturat vendimmarrëse, në trajnime dhe avancime profesionale, etj.

- Shpenzimet e përgjithshme apo shpenzimet në të cilat janë përfshirë çështjet gjinore. Kjo kategori e shpenzimeve, edhe pse në shikim të parë duket të jetë neutrale, megjithatë, në esencë, ajo mund të ketë efekte të ndryshme në lidhje me burrat dhe gratë.

4. Ndjekja e shpenzimeve dhe sigurimi i shërbimeve

- Çka është ajo që fitohet si rezultat i zbatimit të hapave paraprake?
- A janë shpenzuar mjetet ashtu siç është planifikuar?
- Çka është dhënë dhe për kë?
- Kush dhe në çfarë mënyre ka dobënë nga ajo që është bërë?

5. Analiza e rezultateve

- Si është ndikimi i programeve të zbatuara dhe a ofrohet qasja e përmirësuar e burrave dhe grave drejt shërbimeve ekonomike dhe sociale?
- Si janë efektet e veprimeve të ndërmarra në kuptimin e reduktimit të varfërisë, e sidomos për gratë dhe grupet tjera të marginalizuara?

VLERËSIMI I NDIKIMIT MBI LEGJISLACIONIN
Gordana Gapiq Dimitrovska

VLERËSIMI I NDIKIMIT MBI LEGJISLACIONIN

Për nevojat e Projektit “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna” dhe kontributit për krijimin e politikave të ndjeshme ndaj gjinisë dhe veprimeve për fuqizimin ekonomik dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës në nivelin lokal, në këtë pjesë të doracakut është dhënë një përmbajtje e përshtatur nga Doracaku mbi vlerësimin e ndikimit të legjislacionit dhe Doracaku për palët e interesuara – këshillimet gjatë procesit të krijimit të politikave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë⁸.

Kjo pjesë jep informacione të dobishme për gjithë organizatat, grupet dhe individët e interesuar, të cilët dëshirojnë të zbatojnë një Vlerësim të Ndikimit mbi Legjislacionin.

1. Historia

Gjatë disa dekadave të kaluara në BE dhe vendet e tij anëtare, si dhe në vendet anëtare të OECD-së po bëhen përpjekje për rritjen e cilësisë së legjislacionit nëpërmjet të ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve në kuadër të reformës së legjislacionit. Objektivi përfundimtar i futjes në përdorim dhe zbatimit të këtij procesi është që të mundësohet konstatimi i ndikimeve ekonomike dhe sociale, apo i ndikimeve mbi ambientin jetësor nga politika ose legjislacion të caktuara, për të kufizuar shpenzimet dhe ngarkesat administrative të cilat i shkakton legjislacioni për subjektet ekonomik dhe qytetarët, si dhe të mundësohet transparenca dhe pjesëmarrja e publikut në krijimin e politikave.

Duke filluar nga viti 2006, Republika e Maqedonisë vazhdimisht fokusohet në hartimin e legjislacionit e cila bazohet mbi dëshmi, por dhe në bazë të përvojave që kanë qytetarët dhe bizneset duke vepruar në ambientin rregullator. Rolin posaçërisht të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur dy procese: njëri ka të bëjë me procesin e gjyotinës së normave, mekanizëm ky institucional për ekzaminimin e sërishëm të zgjidhjeve për thjeshtëzimin e tyre⁹, ndërkaq i dyti ka të bëjë me miratimin e legjislacionit së re ose me ndryshimet e asaj ekzistuese, duke aplikuar me këtë Vlerësimin e Ndikimit të Legjislacionit (në tekstin e mëtejshëm VNL). VNL po zbatohet duke filluar nga viti 2009 me përkushtim të plotë në këshillimet me palët e interesuara si pjesë të rëndësishme të procedurës së sjelljes së normave, të cilat, përveç dëshmive dhe përvojës sigurojnë dhe transparençën e procesit të përgjithshëm.

2. Çka është VNL?

VNL paraqet një qasje sistematike për përcaktimin dhe vlerësimin e efekteve pozitive dhe negative të legjislacioneve të propozuara – krijimin e politikave me analiza detyrueshëm të bëra të cilat shërbejnë për mbështetjen e masës së propozuar. VNL është një vegël për përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes në kuptimin e legjislacioneve, duke siguruar kornizë për vlerësim sistematik të efekteve potenciale dhe konkrete nga masat legjislative.

Në pajtim me **Rregullat e Punës së Qeverisë**, VNRr po zbatohet për të gjitha propozim-ligjeve të cilat i dërgon Qeverisë për shqyrtim dhe vërtetim.

VNRr nuk zbatohet për propozim të:

- ligjeve miratimi i të cilave propozohet me procedurë urgjente;
- ligjeve mbi ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- ligjeve me të cilat bëhet harmonizimi terminologjik me ligjet tjera;
- Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe
- Ligjit mbi Zbatimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe
- propozim-ligjeve mbi detyrimet dhe garancitë.

Në pajtim me **Metodologjinë e vlerësimit të ndikimit mbi legjislacionin**, procesi po zbatohet në hapat në vijim:

- planifikimi i procesit të zbatimit të VNRr-së;
- zbatimi i procesit të VNRr-së;
- përpilimi i Raportit mbi VNRr;
- këshillimet me palët e interesuara dhe marrja e mendimit nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës;

⁸ http://mioa.gov.mk/files/pdf/Priracnik%20za%20PVR2_mk.pdf dhe http://mioa.gov.mk/files/pdf/Priracnik%20za%20zasegnati%20strani_3.pdf

⁹ Katër faza të normave të gjyotinës r, si vijon: në fazën I të normave të gjyotinës, masat që u ndërmorën përfshinin rekomandime për ndryshim, plotësim apo revokimi i normave (ligjeve dhe akteve nënligjore), në fazën II u zbatua një pako masash, qëllimi i të cilave ishte që konsiderueshëm të kontribuonin për lehtësimin e punës së kompanive, rritjen e konkurrencës së tyre dhe përshtetshësinë e frekuentimit ndërkufitar të mallrave, në fazën III, në mënyrë transparente, u doli krah kërkesave të komunitetit afarist, me qëllim përmirësimi i klimës së biznesit dhe mënjanimi i pengesave administrative, nëpërmjet të rregullimit plotësues të kornizës juridike, sidomos të normave që propozojnë ndërlikimin e procedurave ose që parashtron kërkesa të stërmëdha nga subjektet afarist dhe faza IV – “Përparësi për të vegjlit” është fokusuar në thjeshtëzimin e kushteve të punës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

VNL ka një rol të dyfishtë, pasi paraqet:

- A) Një proces të vazhdueshëm i cili mundëson analizimin e shkaqeve për futjen në përdorim të masave konkrete, të përcaktohen zgjidhjet e mundshme, gjegjësisht, alternativat për arritjen e qëllimit, të ekzaminohen dhe kuptohen pasojat nga masat e propozuara dhe të inkuadrohen palët e interesuara në të gjitha fazat e procesit dhe
- B) Një vegël e cila ndihmon përpilimin e propozim-legjislacionit nëpërmjet të analizimit të shpenzimeve dhe përfitimeve të mundshme, si dhe të rreziqeve të cilat do të mund të kishin ndikim mbi qytetarët, ekonominë, subjektet afaristë, shoqërinë dhe ambientin jetësor, për një afat më të gjatë.

Zbatimi i VNL-së mundëson konstatimin e ndikimeve ekonomike dhe sociale ose të ndikimeve mbi ambientin jetësor nga politikat ose legjislacionit, por dhe efekteve të paparashikuara dhe të padëshiruara nga legjislacion, reduktimi i shpenzimeve dhe ngarkesave administrative të cilat i shkakton legjislacion për qytetarët dhe subjektet afarist dhe sigurimi i transparencës dhe pjesëmarrja e publikut në krijimin e politikave.

3. Korniza juridike

Kornizën juridike nëpërmjet të së cilës duhet siguruar një proces cilësor të hartimit të ligjeve, legjislacionit nënligjorë dhe dokumenteve strategjike e përbëjnë aktet nënligjorë dhe dokumentet në vijim: Rregullorja e Punës së Qeverisë, Metodologjia e planifikimit strategjik dhe përpilimit të Programit vjetor të Punës së Qeverisë, Metodologjia e analizës së politikave dhe koordinimit, Metodologjia e vlerësimit të ndikimit të legjislacionit, Vendimi mbi formën dhe përmbajtjen e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit të Legjislacionit, Udhëzimi mbi mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të legjislacionit, Metodologjia mbi vlerësimin e zbatimit të legjislacionit.

4. Zbatimi i VNL-së

VNL është një proces i vazhdueshëm, i cili mundëson të mendohet nëpërmjet të pasojave nga intervenimeve të mundshme dhe reale të Qeverisë në legjislacion, edhe atë në fazat e hershme të identifikimit të sfidave/problemeve, nëpërmjet të zhvillimit të alternativave të mundshme, këshillimeve, sjelljes përfundimtare të vendimeve dhe vlerësimit të zbatimit të alternativës së propozuar.

Vlerësimi zbatohet me qëllim sigurimi i ndryshimeve të mëvonshme në legjislacionin përkatës dhe të ndihmojë për të identifikuar sfidat e reja, madje para fillimit të procesit të ri të krijimit të politikave.

Me Udhëzimin mbi mënyrën e veprimit në punën e ministrive gjatë procesit të zbatimit të vlerësimit të ndikimit mbi legjislacionin, nga më afër rregullohet mënyra e:

- Planifikimit të VNL-së
- Përpilimit të Planit Vjetor për VNL
- Përpilimit të Lajmërimit mbi fillimin e procesit të hartimit të një propozim-ligji
- Zbatimit të procesit të VNL-së
- Shpalljes në ENER dhe në ueb-faqen e Ministrisë
- Sigurimit të mendimit nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
- Përgatitjes së propozim-Raportit mbi VNL,
- Shpalljes së Raportit mbi VNL së bashku me propozim të Ligjit mbi ENER.

Gjatë zbatimit të VNL-së, me rëndësi janë fazat në vijim:

- Analiza e gjendjeve, definimi i problemit dhe përcaktimi i qëllimeve
- Përcaktimi i zgjidhjeve të mundshme (alternativave)
- Analiza e shpenzimeve, ndikimeve dhe përfitimeve nga zgjidhjet e mundshme të përcaktuara (alternativave) dhe krahasimi i tyre
- Planifikimi i mënyrës së zbatimit, ndjekjes dhe vlerësimit.

Fazat në procesin e vlerësimit mund të përsëriten dhe jo çdoherë ato mund të ndërmerren në konsekuencë.

1.5 Analiza e gjendjeve, definimi i problemit dhe përcaktimi i qëllimeve


Pikënisja në procesin e zbatimit të VNL-së është analiza e gjendjeve në lëmin dhe/ose fushat e ngjashme që janë lëndë e rregullimit, me qëllim vërtetimi i ekzistimit dhe seriozitetit të problemit.

Me këtë analizë përcaktohen:

- arsyet që kontribuojnë për ekzistimin e problemit, të bazuar mbi fakte,
- normat ekzistuese që ndikojnë problemin, dhe
- lidhshmëria me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuar anë pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Me analizën e gjendjes vërtetohet serioziteti i problemit, gjegjësisht, shfaqja e mundshme ose rreziqet nga shfaqja e pasojave të dëmshme, nëse nuk intervenohet nëpërmjet të masave ligjore ose masave tjera.


Pyetje të cilat mund të ndihmojnë gjatë analizimit të gjendjes dhe definimit të problemit:



Në bazë të analizës së gjendjes dhe problemit të vërtetuar, definojnë qëllimet të cilat duhet të arrihen me zbatimin e propozim-zgjidhjes. Pa pasqyrë të qartë për atë se çka duhet arritur nuk do të mund të përcaktohen masat e mundshme, të krahasohen alternativat për zgjidhjen e problemit të vërtetuar, e as të ndiqet zbatimi dhe të vlerësohet suksesi.

Qëllimet duhet të formulohen qartë dhe të përqendrohen në rezultatin apo gjendjen përfundimtare të dëshiruar i cili duhet të arrihet me zbatimin e legjislacionit. Gjithashtu, qëllimet nuk duhet të definojnë në mënyrë që do ta arsyetojnë zgjidhjen e mundshme të preferuar. Qëllimet e definuara paraqesin bazën e analizave të mëtejshme gjatë përcaktimit të zgjidhjeve të mundshme dhe masave për arritjen e tyre.

Që më lehtë të përcaktohen qëllimet, pyetjet në vijim do të mund të ndihmojnë pyetjet në vijim:



1.6. Përcaktimi i zgjidhjeve të mundshme (alternativat)

Pas definimit të qëllimeve që duhet t'i arrijë legjislacioni, hapi vijues në proces është të përcaktohen zgjidhjet e mundshme (alternativat) për zgjidhjen e problemit të vërtetuar dhe arritjen e qëllimeve të dëshiruara. Alternativat duhet të jenë të lidhura ngushtë me arsyet e shfaqjes së problemit dhe me qëllimet e përcaktuara. Gjatë shqyrtimit të alternativave, duhet patur parasysh se ekzistojnë 2 lloje të alternativave, si vijon:

Alternativat që kanë të bëjnë me përmbajtjen e masave që mund të ndërmerren ▶ për shembull: ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirat publike dhe/ose akciza më të mëdha për cigaret, ndërtimi i godinave të reja të banimit të menduara për banim social ose subvencionim të qirave në banesa tanimë ekzistuese, etj.	Alternativat që kanë të bëjnë me instrumentet nëpërmjet të të cilave po zbatohen vendimet e mundshme. Për shembull: ▶ masat ligjore – ligjet dhe legjislacionin nënligjor; ▶ masat ekonomike – subvencionet, tatimet, taksat, akcizat e ngjashëm, dhe ▶ masat joligjore – vetregullimi, masat e bindjes, siç janë fushatat, informacionet e ngjashëm.
Shpesh nuk mund të bëhet ndarja e qartë midis dy llojeve të alternativave, pasi ato plotësohen mes vete. Sipas rregullës, me e mira është: ✓ së pari të caktohet përmbajtja e masave, e pastaj ✓ të caktohen instrumentet e zbatimit.	

Hapi i parë në definimin e zgjidhjeve të mundshme është analiza e **skenarit bazë**, gjegjësisht **alternativën “mos bë asgjë”**. Qëllimi i skenarit bazë është të prezantohen pasojat të cilat do të mund të ishin krijuar nëse nuk do të intervenohet me propozim-ligjin ose me masa tjera. Me këtë alternativë na jepet një projektim i zhvillimit të mundshëm të gjendjes dhe cilat pasoja të dëmshme mund të shfaqen me kalimin e kohës.

Varësisht nga ajo sa është materia dhe problemi i ndërlikuar, në fillim të procesit duhet definuar sa është e mundur më shumë alternativa për zgjidhje të problemit. Pastaj, në bazë të konstatimit të ndikimeve të përgjithshme, nga secilën nga zgjidhjet e mundshme duhet përcaktuar numrin real të zgjidhjeve të mundshme, të cilat pastaj analizohen në detaje. Pyetjet në vijim mund të ndihmojnë gjatë përcaktimit të zgjidhjeve të mundshme (alternativat):

Shkalla e ndikimeve të mundshme – Shpenzimet administrative dhe shpenzimet e procedimit (respektimit) të cilat do të ishin imponuar me këtë alternativë duhet qenë sa më të ulëta. Alternativat që parashikojnë masa ekonomike dhe të cilat potencialisht mund të ndikojnë mbi kufizimin e konkurrencës ose të faktorëve tjerë në treg, sidomos tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duhet reduktuar në minimum.
Ndërvarësia e kornizës juridike – Gjatë ekzaminimit të efikasitetit të secilës nga zgjidhjet e mundshme duhet përcaktuar se si secila nga zgjidhjet e mundshme do të funksionojë në kuptimin e legjislacionit ekzistues në lëmin, ose fushat e ngjashme në lidhje me problemin, për të përcaktuar çfarëdo kundërshtimesh ose përplasjesh.
Zbatimi i legjislacionit ekzistues – Nëse tanimë ekziston një ligj mi po të njëjtës çështje, duhet analizuar arsyet përse ligji ekzistues nuk ofron efektet e dëshiruara – miratimi i një ligji të ri ose ndryshimi i tij nuk do të thotë gjithmonë dhe zgjidhje të problemit.
Zbatimi, procedurat dhe informacionet – Duhet shqyrtuar dhe përshkruar të gjitha procedurat dhe informacionet të cilat qytetarët dhe/ose kompanitë do të duhet t'i respektojnë ose nënshtrajnë, pasi ato drejtpërsëdrejti kanë ndikim mbi suksesin e zbatimit të legjislacionit dhe arritjes së efekteve.

Më poshtë është dhënë një pasqyrë e pyetjeve që mund të Ju ndihmojnë gjatë përcaktimit të zgjidhjeve të mundshme (alternativa):

EFIKASITETI	• Cilat alternativa do t'i arrijnë qëllimet në mënyrën më efektive? • A ekzistojnë kufizime që duhet të merren parasysh gjatë konstatimit të alternativave?
INSTRUMENTET	• A do të arrihet qëllimi më së miri me masa ligjore/joligjore? • A mund të arrihet qëllimi vetëm me masa joligjore?
DEFINIMI	• A janë përshkruar alternativat me detaje të mjaftueshme për të mundësuar analizën e shpenzimeve dhe përfitimet nga secila alternativë? • A janë vërtetuar të gjitha alternativat reale?

1.7 Analiza e shpenzimeve, ndikimeve dhe përfitimeve nga zgjidhjet e vërtetuara të mundshme (alternativat) dhe krahasimi i tyre

Pasi të vërtetohen zgjidhjet e mundshme (alternativat), hapi vijues është analizimi.

Qëllimi i analizave është të fitohet një pasqyrë e qartë e shpenzimeve, ndikimeve pozitive dhe negative dhe përfitimeve që do të kishin dalë nga secilën nga zgjidhjet e mundshme, që të mund të përcaktohet se cila nga alternativat do të çojë drejt qëllimeve të planifikuara me shpenzime minimale (për buxhetin, subjektet afariste dhe qytetarët) dhe efekteve të padëshiruara. Rezultati përfundimtar i kësaj faze të procesit është të arrihet deri tek ajo zgjidhje me të cilën do të sigurohet vlera e cila tejkalon shpenzimet ose çfarëdo ndikimesh negative të cilat do të mund të ishin shkaktuar.

Secila nga zgjidhjet e mundshme të vërtetuara mund të shkaktojë lloje dhe shkallë të ndryshme të shpenzimeve, të cilat përcaktohen në mënyrë sa më të përpiktë.

Me analizën duhet të përcaktohen:

- shpenzimet/përfitimi për buxhetin;
- shpenzimet e subjekteve afariste, sidomos ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, grupet tjera të qytetarëve (varësisht nga ajo se me cilin ka të bëjë propozimi i ligjit);
- ndikimet mbi ekonominë, ndikimet sociale, ndikimet mbi ambientin jetësor dhe shëndetin e njerëzve, si dhe llojet tjera të ndikimeve, varësisht nga fusha;
- shpenzimet dhe resurset e nevojshme për zbatimin, ndjekjen dhe kontrollin, si dhe vlerësimin e secilës nga zgjidhjet e mundshme;
- pranimi/rezistenca që mund të shfaqet gjatë zbatimit dhe
- efektet negative ose të padëshiruara dhe ndikimet.

Me analizimin e zgjidhjeve të mundshme të vërtetuara (alternativat), përdoren metoda dhe vegla të ndryshme analitike:

- analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve,
- analiza e shpenzimeve dhe efikasitetit,
- analiza me shumë kritere, analiza e rreziqeve,
- modeli i shpenzimeve standarde, etj.

Më poshtë është prezantuar pasqyra e pyetjeve që përdoren gjatë analizës së shpenzimeve, ndikimeve dhe përfitimeve nga zgjidhjet e mundshme të vërtetuara, si dhe krahasimi i tyre.



1.8 Zbatimi, ndjekja dhe vlerësimi

Pyetjet lidhur me zbatimin, ndjekjen dhe vlerësimin paraqesin një pjesë të rëndësishme të analizës në zgjedhjen e alternativës e cila do të rekomandohet si më përkatëse.

Zbatimi duhet të ndiqet rregullisht për të përcaktuar nevojën për aplikimin e masave të reja për konsistencë në zbatim ose për ndryshimin e normave. Efektet e zbatimit mund të ndjehen në një afat të shkurtër ose të gjatë, varësisht nga lëmi, dhe në përputhje me këtë, duhet parashikuar kornizën kohore dhe procedurat për vlerësimin e arritjes së efekteve të pritura.

Në këtë fazë, nevojitet të jepet përgjigja në pyetjet në vijim:

- Kush do të preket me propozim-ligjin ose zgjidhjen?
- Çfarë ndryshimesh në sjellje presim nga palët e interesuara për t'i arritur rezultatet e dëshiruara?
- Çfarë rezistencash ose pengesash mund të shfaqen gjatë arritjes së ndryshimeve?
- Çfarë masash duhet të aplikohen për të nxitur ndryshimet në sjellje?
- Çfarë procedurash për ndjekje duhet të aplikohen për të vërtetuar çfarëdo problemesh në zbatim dhe për të mundësuar reagimin me kohë?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të tregojnë nevojën për: futjen në përdorim të aplikimit të shtyrë të ligjit dhe futjen në përdorim të masave joligjore.

Në fazën e ndjekjes duhet menduar rreth asaj se si do të ndiqet dhe matet efikasiteti e masave që po aplikohen me zgjidhjen e re, cilët tregues do të përdoren, çfarë të dhënash do të grumbullohen dhe kush do t'i grumbullojë të dhënat, do të definohen intervale të rregullta të ndjekjes dhe përpilimit të raporteve mbi konsistencën e zbatimit të legjislacionit.

Vlerësimi është një projekt i posaçëm i planifikuar me metodologji të përcaktuar, i cili ka për qëllim që në mënyrë kritike ta ekzaminojë dhe vlerësojë efikasitetin e të gjitha aspekteve të politikës ose ligjit. Zbatohet pas një periudhe të caktuar nga futja në përdorim të politikës ose nga hyrja në fuqi të ligjit, me qëllim të vërtetohet:

- nëse janë arritur qëllimet e planifikuara të politikës/ligjit në mënyrë efikase;
- nëse dhe deri në cilën shkallë janë paraqitur efektet e padëshiruara;
- nëse ligji në mënyrë të vazhdueshme është respektuar dhe cilat kanë qenë arsyet e mosrespektimit.

1.9 Këshillimet

Këshillimet me palët e interesuara paraqesin pjesë përbërëse të procesit të VNL-së dhe janë një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së legjislacionit dhe avancimin e efikasitetit dhe efikasitetit të zbatimit të masave të parashikuara. Këshillimet kontribuojnë për një transparencë të rritur në punën dhe procesin e vendimmarrës, gjë kjo me të cilën fuqizohen mekanizmat bazë të demokracisë.

*Palët “e brendshme” të interesuara janë:
Ministritë dhe organet tjera të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet tjera shtetërore të cilat mund të kenë kompetenca ose interesa të ndara në propozim-legjislacionin.*

*Palët “e jashtme” të interesuara janë:
Subjektet afariste, sindikatat, organizatat joqeveritare, shoqatat dhe fondacionet, grupet e qytetarëve dhe qytetarët që janë të interesuar ose të cilët drejtpërsëdrejti lidhen me propozim-legjislacionin.*

Këshilla - KUR?

- Gjatë hartimit të strategjive në fusha të caktuara në kompetencë të Qeverisë
- Gjatë përpilimit të planeve strategjike të ministrive – nga fillimi i muajit maj deri në fund të muajit gusht gjatë vitit aktual – me iniciativa dhe masa
- Gjatë definimit të Programit Vjetor të Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë – propozim-nismat në lëmin përkatës.
- Gjatë hartimit të ligjeve – me procesin e VNRR-së dhe hartimit të propozimeve të ligjeve.
- Gjatë zbatimit të ligjeve dhe legjislacionit nënligjorë me ndjekjen e zbatimit praktik dhe dhënies së nismave për përmirësimin e efikasitetit dhe efikasitetit të zbatimit

Me këshillimet sigurohet:

- mbledhja e informacioneve të rëndësishme të cilat kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së zgjidhjeve;
- kontrollimi i analizave zbatuara gjatë VNL-së dhe mundësia për zbulim të hershëm të mungesave të mundshme dhe të zgjidhjeve të mundshme;
- pranimi më i mirë i politikës ose ligjit, pasi pjesëmarrja e palëve të interesuara rrit probabilitetin e rezistencave të pakësuar gjatë zbatimit;
- kuptimi dhe respektimi më i mirë i dispozitave ligjore, dhe me këtë dhe efikasiteti më e madhe e ligjit.

Këshillimet efektive mbajnë tiparet në vijim:


- TË VAZHDUESHME
- TË MËKOHSHME
- GJITHPËRFSHIRËSE
- PËRKATËSE DHE TË QASSHME
- TRANSPARENTE
- TË QARTA

Këshillimet zbatohen gjatë tërë procesit të VNL-së, pra gjatë:


- **Analizës së gjendjeve** – mbledhja e informacioneve mbi problemet ekzistuese dhe përvojat nga zbatimi i politikës ose ligjit aktual
- **Vërtetimit të zgjidhjeve të mundshme** – të shqyrtohen alternativat, zbatimi i tyre, leverdia dhe zgjidhjet e mundshme
- **Vlerësimit të ndikimeve të mundshme** – të shqyrtohen të gjitha zgjidhjet e mundshme me organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, OJQ-të dhe palët tjera të interesuara.
- Këshillimet duhet të planifikohen që në fazën e përpilimit të planit të zbatimit VNL, gjë kjo me të cilën do të përcaktohen palët e interesuara (të brendshme dhe të jashtme) dhe rreth të cilave do të zhvillohet diskutimi.

Ekzistojnë tre forma të kundërveprimit me palët e interesuara: **informimi, këshillimet dhe pjesëmarrja**. Në praktikë, këto tre forma të kundërveprimit shpesh kombinohen gjatë hartimit të ligjeve.¹⁰

Informimi nënkupton transmetimin transparent të informacioneve në publik. Informimi është proces linear i komunikimit, në të cilin publiku ka rolin e pranuesit pasiv të informacioneve. Informimi në vete nuk paraqet një proces këshillimi, por është hapi i parë me të cilin mundësohet që palët e interesuara të përgatiten me kohë për këshillimet e paralajmëruara.



Këshillimet janë kërkim aktiv të mendimit nga palët e interesuara nëpërmjet të këmbimit të dyanshëm të informacioneve në të gjitha fazat të procesit të hartimit të legjislacionit, gjegjësisht, nga definimi i problemit e deri në vlerësimin e zgjidhjeve të mundshme. Qëllimi kryesor i këshillimeve është grumbullimi i informacioneve të nevojshme për zbatimin e analizave të detajuara dhe konstatimit të qëndrimeve të ndryshme, gjë kjo me të cilën kontribuohet për rritjen e cilësisë së ligjeve.



Pjesëmarrja paraqet inkuadrim aktiv të palëve të interesuara në formulimin e përmbajtjes së legjislacionit. Institucionet kompetente, më së shpesh, me formimin e grupeve të punës, u mundësojnë palëve të interesuara pjesëmarrje në hartimin dhe/ose zbatimin e legjislacionit.



Ekzistojnë më tepër mënyra të mundshme të këshillimeve, si për shembull:

- inspektimi publik dhe debati publik;
- kërkimi i mendimeve me shkrim, vërejtjeve dhe sugjerimeve nga palët e interesuara;
- pjesëmarrja në grupe të punës, të formuara nga Ministria ose nga Qeveria;
- takimet me palët e interesuara;
- debatet publike për çështje të caktuara, me shfrytëzimin veçanërisht të veglave interaktive elektronike, të vëna në dispozicion në portalet ENER dhe E-demokracia.

5. ÇKA ËSHTË ENER?

Regjistri i Vetëm Kombëtar Elektronik i Rregullave – ENER (www.ener.gov.mk) është një sistem elektronik i cili përmban rregulla, propozim-ligje të ministrive në fazën e përpilimit dhe raport nga vlerësimi i zbatuar i ndikimit të legjislacionit - VNL¹¹.

Për çka është menduar ENER?

- për informim elektronik të qytetarëve dhe organizatave joqeveritare, subjekteve afariste dhe ministrive,
- për mbështetjen e procesit të Vlerësimit të Ndikimit mbi Legjislacionin (VNL),
- për përfshirjen e opinionit publik në përmirësimin e propozim-ligjeve, kur ato po krijohen,
- për transparencë të rritur gjatë sjelljes së propozim-ligjeve nga Qeveria dhe nxitje të pjesëmarrjes së publikut gjatë hartimit të rregullave.

¹⁰ Ekstrakt nga Dokumenti Mbështetës mbi Këshillimin Publik (Background Document on Public Consultation), OECD, <http://www.oecd.org/dataoecd/4/43/36785341.pdf>

¹¹ Ekstrakt nga Doracaku për palët e interesuara - Këshillimet në procesin e krijimit të politikave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, http://mioa.gov.mk/files/pdf/Priracnik%20za%20zasegnati%20strani_3.pdf

Si deri tek komentet dhe informacionet e rregullta?

- Me anëtarësimin në ENER:
- jepni komente, propozime dhe mendime,
- zgjidhni fushën Tuaj të interesit për marrje të lajmërimeve në kohë rreth risive të ENER-it,
- mësoni se cilat rregulla janë më interesante dhe kanë marrë më së shumti komente nga shfrytëzuesit e ENER-it,
- kini qasje në rregullën dhe komentet e shfrytëzuesve të ENER-it,
- ndiqni 10 rregullat e fundit të propozuara, të cilat ende nuk janë vërtetuar nga Qeveria dhe inkuadrohuni.

6. ÇKA ËSHTË E-DEMOKRACIA?

Ueb - portali “e-demokracia” (www.e-demokratija.mk) është përgjigje e nevojës për aplikimin e një metode të re bashkëkohore të debatit publik, i cili, me shfrytëzimin e veglave interaktive, ka për qëllim ta mbështesë pjesëmarrjen në jetën publike, ta fuqizojë komunitetin dhe ta avancojë demokracinë¹²

Për çka është menduar protali e-demokracia?

- për informim elektronik dhe kundërveprim me qytetarët dhe organizatat joqeveritare, subjektet afariste dhe ministrinë,
- për rishikim, ruajtje dhe komentim të dokumenteve në hartim e sipër dhe dokumenteve të miratuara në fusha të caktuara,
- për inkuadrim dhe komentim në debatet tematike në pjesën “forumi”,
- për vendosje të shkrimeve, gjegjësisht, publikimeve të shoqatave dhe fondacioneve, odave ekonomike, sindikatave, kompanive dhe personave tjerë juridik,
- për parashtrim të ideve, komenteve ose mendimeve me qëllim funksionimi më efikas i administratës.

Si deri tek komentet dhe informacionet e rregullta?

Me anëtarësimin në e-demokracia:

- jepni komente, propozime dhe mendime,
- zgjidhni fushën Tuaj të interesit për pranim në kohë të lajmërimeve rreth risive të ENER-it,
- propozoni temë diskutimi në forum, publikoni shkrimin Tuaj ose jepni një ide,
- mësoni se cilat dokumente dhe tema të debateve në forum janë më interesante,
- kini qasje në përmbajtjet dhe komentet e shfrytëzuesve të e-demokracia,
- ndiqni dokumentet e fundit të propozuara, të cilat ende nuk janë vërtetuar nga Qeveria dhe inkuadrohuni.

¹² Ekstrakt nga Doracaku për palët e interesuara – Këshillimet në procesin e krijimit të politikave në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, http://mioa.gov.mk/files/pdf/Priracnik%20za%20zasegnati%20strani_3.pdf

**MONITORIMI DHE VLERËSIMI I
POLITIKAVE PUBLIKE**
Riste Jurukovski

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I POLITIKAVE PUBLIKE

1. Definimi i monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi janë dy procese paralele, të varura mes vete në mënyrë të ndërsjellë, dhe zbatohen me qëllim marrja e njohurive dhe informacioneve nga aplikimi i një politike të caktuar. Informacionet dhe të dhënat që dalin nga këto procese paraqesin drejtime kryesore dhe fakte në planifikimin strategjik për atë se cilat politika janë më të pranueshme dhe më efikase, gjë kjo e cila mundëson përmirësim brenda procesit të krijimit të politikave publike. Nëse nevojitet të bëhet dallimi midis këtyre dy proceseve, kjo sigurisht se do të ishte koha kur ato po zhvillohen dhe - cila është lënda e këtyre aktiviteteve. Së pari, vlerësimi zbatohet si para, ashtu dhe pas përfundimit të politikës, ndërsa monitorimi bëhet ose gjatë zbatimit të politikës, ose pas kësaj. Megjithatë, dallimi kryesor është se vlerësimi është i orientuar drejt rezultateve, ndërsa monitorimi drejt procesit, gjegjësisht, drejt procedurave dhe aktiviteteve. Në vazhdim, dy proceset janë përshkruar në detaje.

Monitorimi

Monitorimi paraqet një proces të vazhdueshëm të mbledhjes sistematike të të dhënave, në përputhje me tregues të konstatuar, me qëllim ndjekja e shkallës së progresit dhe realizimi i qëllimeve dhe politikave të vendosura¹³. Nevoja për monitorim shfaqet pasi zbatimi i politikave publike zgjatë shumë, dhe politikat publike kanë ndikim të madh mbi një numri të madh të palëve të interesuara. Për suksesin e zbatimit të politikës publike ndikojnë shumë faktorë, ndikimi i të cilëve është i ndërlikuar dhe jo çdoherë është njohur deri në fund në kohën kur skicohen politikat publike, dhe kështu efektet e politikave publike mund të jenë jashtëzakonisht të vështira për palët e interesuara. Pastaj, me skicimin e politikave, gjithë faktorët nuk janë të njohur dhe prandaj nuk mund të merren parasysh, dhe shumica e tyre, në kohën kur po zbatohet politika publike, po ndryshohen. Të gjithë këto aspekte imponojnë monitorim gjatë kohës së zbatimit të politikës publike, për të shmangur veprimet negative dhe për të ndërmarrë masa për korrigjim në kohë.

Vlerësimi

Për dallim nga monitorimi, për vlerësimin ekzistojnë më tepër përkufizime të cilët sqarojnë atë si proces. Megjithatë, në esencë, vlerësimi paraqet një përmbledhje të metodave hulumtuese që kanë për qëllim që në mënyrë sistematike ta vlerësojnë efikasitetin e politikës së caktuar, me qëllim avancimi dhe përmirësimi i saj. Njëri nga përkufizimet më gjithëpërfshirës për vlerësim është ky në vijim: Vlerësimi paraqet matje metodologjike dhe objektive e zbatimit të rezultateve nga një politike aktuale ose të përfunduar. Qëllimi është të përcaktohet përshtatshmëria dhe realizimi i qëllimeve, efikasitetit, efikasitetit, si dhe ndikimi dhe qëndrueshmëria e politikës publike, gjë kjo e cila është lëndë e vlerësimit¹⁴.

Më së shumti definohen dy lloje të vlerësimit, të cilët hollësisht do të jenë lëndë e kësaj metodologjie, dhe ato janë:

Vlerësimi i procesit (formal) – në përgjithësi, zhvillohet para dhe gjatë kohës së zbatimit të politikës, me qëllim të ndërmerren masa në kohë dhe të përmirësohet realizmi, gjegjësisht, të përcaktohet se nën cilat kushte politika ose projekti do të realizohen më mirë.

Vlerësimi i ndikimit (përmbledhës) – më së shumti bëhet pas përfundimit ose pas zbatimit të politikës dhe në fakt, i përgjigjet pyetjes – nëse politika ka qenë e suksesshme dhe sa janë efektet e saja.

Duke patur parasysh këto lloje të vlerësimit, mund të vijmë në përfundim se vlerësimi përfshin:

- Rishikimin e asaj të cilën politika duhet ta arrijë – çfarë zhvendosje kemi për qëllim të bëjmë? Çfarë ndikimi përqipemi të arrihet?
- Vlerësimi i progresit në kuptimin e asaj të cilën dëshirojmë ta arrijmë;
- Rishikimi i strategjisë (planeve strategjike) të institucionit i cili zbaton politikën – a ndjek politika planin strategjik në mënyrë efektive? A është strategjia e suksesshme? Nëse nuk është – përse nuk është?
- Rishikimi i punës – a janë shfrytëzuar resurset në mënyrë efektive? Si kanë qenë shpenzimet? Si është qëndrueshmëria? Çfarë ndërlikimesh ekzistojnë për palët e ndryshme të interesuara?

¹³ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (Organisation for Economic Cooperation and Development) (OECD). Fjalor I termeve kryesore në administrimin e bazuar në vlerësime dhe rezultate (Glossary of Key Terms in Evaluation and Results Based Management), viti 2002

¹⁴ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (Organisation for Economic Cooperation and Development) (OECD). Fjalor I termeve kryesore në administrimin e bazuar në vlerësime dhe rezultate (Glossary of Key Terms in Evaluation and Results Based Management), viti 2002

Vlerësimi Ex-ante dhe Ex-post

Kjo ndarje bëhet sipas kohës së realizimit në proporcion me kohën e zbatimit të politikës. Për vlerësimin Ex-post do të flitet më gjerësisht më poshtë në tekst.

Vlerësimi ex-ante zhvillohet në pjesën e procesit të krijimit të politikave, kur shqyrtohen dhe krahasohen alternativat e mundshme për zbatim, përpara se të përzgjidhet ndonjë alternativë. Në procesin e krijimit të politikave publike, përdorimi i vlerësimit ex ante bëhet në hapin e parë të formulimit të politikës publike, gjegjësisht kur përcaktohen nevojat, kur identifikohen problemet dhe kur vendosen qëllimet e politikës. Në këtë fazë analizohen dhe krahasohen alternativat e mundshme, ndërsa rezultatet shfrytëzohen për formulimin e alternativës përfundimtare e cila do të zbatohet në fazat e ardhshme.

2. Planifikimi i monitorimit dhe i vlerësimit

Siç mund të përfundonim, monitorimi dhe vlerësimi kanë një rol të rëndësishëm në realizimin e plotë të një politike të caktuar, dhe kështu zbatimi i tyre duhet të planifikohet mirë. Ato duhet të udhëhiqen nga nevoja për arritje të rezultateve të dëshiruara dhe të orientohen drejt sigurimit të dëshmive dhe fakteve, të cilat do të përfaqësojnë bazën në procesin e vendimmarrjes.

Që të jenë vërtetë të vlefshme, dhe vlerësimi i arritjeve të jetë relevant, monitorimi dhe vlerësimi duhet patjetër të planifikohen me kujdes dhe me cilësi dhe të bazohen mbi strategji. Një strategji e qëndrueshme e monitorimit dhe vlerësimit jep një pasqyrë të plotë të veglave të nevojshme për mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore, jep përshkrimin e anëve të dobëta dhe të fuqishme të tyre, dhe tregon drejt një propozimi – kur është e përshtatshme të përdoret ndonjëri nga modelet. Është kjo arsyeja që për çdo model ekziston procedura e ndryshme për përdorimin e tij, secili model është i qasshëm në mënyrë të ndryshme, më pak apo më shumë është relevant, i përshtatshëm, i besueshëm i përpiktë dhe me përgjigje.

Nuk ekziston mënyra e vetme e planifikimit të monitorimit dhe vlerësimit, por çdoherë nevojitet që palët e interesuara (organizatat joqeveritare, krijuesit e politikave) të zhvillojnë një kornizë të posaçme, të përshtatshme për monitorimin dhe vlerësimin e politikës. Korniza, në fakt, paraqet planin e monitorimit dhe vlerësimit, gjë kjo e cila duhet t'u jep përgjigje listës së pyetjeve në vijim¹⁵:

Çka duhet monitoruar dhe vlerësuar?	
1. Cilat aktivitete duhet të monitorohen dhe vlerësohen?	
2. Kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve?	
3. Kur janë planifikuar aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit?	
4. Sipas cilët tregues do të bëhet monitorimi dhe vlerësimi?	
5. Cilat metoda do të përdoren për monitorim dhe vlerësim?	
6. Cilat janë resurset e nevojshme?	
7. Cilat janë rreziqet dhe supozimet e mundshme?	

Korniza e monitorimit dhe vlerësimit më së shumti mund të ndahet në tre komponentë bazë:

1. Pjesa narrative

2. Rezultatet e pritura

3. Krijimi i matricës për monitorim dhe vlerësim

¹⁵ <http://web.undp.org/evaluation/handbook/documents/english/pme handbook.pdf>

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit –vlerësimit

Edhe pse dy proceset janë paralele njëri me tjetrin, përkatësisht bëhen veçmas, megjithatë duhet të kalojnë fazat themelore me të cilat krahasohen:

- zhvillimi i indikatorëve ;
- përcaktimi i kriterëve dhe monitorimi i vlerësimit;
- vendosjen e sistemit për grumbullimin e informacioneve në raport me indikatorët;
- grumbullimin dhe dokumentimin e informacioneve;
- analiza e informacioneve;
- përdorimi i informacioneve;

Në tekstin në vazhdim çdo fazë do të shpjegohet veçmas.

Zhvillimi i indikatorëve

Monitorimi dhe vlerësimi që të jenë të suksesshëm, në fillim duhet të vendosen indikatorët. Përcaktimi i indikatorëve nuk lidhet vetëm me vet procesin e monitorimit dhe të vlerësimit, por indikatorët vendosen para vendosjes të vet politikës. Në një farë forme indikatorët vendosen gjatë dizajnit të politikës, kështu që ata paraqesin pritshmëri për atë sa politika do të jetë e kujdesshme. Indikatorët maten dhe janë tregues të dukshëm se diçka nuk është bërë dhe diçka nuk është bërë dhe se diçka nuk është arritur. Këto janë pjesë esenciale, pikënisje e procesit të monitorimit dhe vlerësimit, sepse tregojnë - çfarë duhet të matet ose të monitorohet më vonë.

Indikatorët duhet herët të përcaktohen, që të mundet menjëherë të fillohet me grumbullimin e informacioneve. Për të monitoruar efektivitetin, efikasitetin, ndikimin dhe kriterë të tjera, duhet që treguesit të zhvillohen. Kjo më së miri mund të bëhet përmes një skeme të veçantë, të përshkruar më poshtë në tekst, e shpjeguar përmes rastit konkret nga Studimi i rastit mbi monitorimin dhe vlerësimin e politikave për pavarësinë e gjyqësorit.

Treguesit themelorë (bazë)

Treguesit themelorë (bazë) paraqesin të dhëna për situatën aktuale, të iniciuar para aplikimit të politikës. Këto janë informacionit të bazuara në analizën e politikës. Gjendja fillestare, pavarësisht analizës shërben për të përcaktuar drejtimin dhe matjen e intensitetit të ndryshimit, sepse ajo është shumë e vështirë për të matur ndikimin në qoftë se nuk keni të dhëna për gjendjen e mëparshme. Treguesit kryesorë janë të bazuara në rëndësinë e të dhënave primare për matjen e tyre. Ka nivele të ndryshme të të dhënave bazë:

- informacione të përgjithshme mbi situatën, shpesh në dispozicion si statistika zyrtare, por në qoftë se puna zhvillohet në një zonë të caktuar gjeografike, atëherë duhen të dhëna për këtë zonë gjeografike; nëse nuk ka statistika zyrtare, është e nevojshme të dhënat të grumbullohen në mënyrë të pavarur;
- Informacionet specifike fitohen kur ndikimi, matet përmes mostrës - atëherë informacionet është i nevojshëm vetëm për këtë mostër; quajtur informacion specifik për shkak se ato nuk zbatohen për situatën e përgjithshme, siç është rasti me informacione të përgjithshme; në rastin kur është fjala për individë, atëherë të dhënat e nevojshme pikërisht për ata individë para se të filloni të punoni me ta.

Treguesit për realizim

Treguesit për realizim paraqesin masa për informacionet hyrëse, produktet dhe ndikimet e politikave publike, projekte, programe apo strategjive. Ato janë të dobishme për vendosjen e qëllimeve të realizimit dhe vlerësimin e progresit në arritjen e politikave publike. Këta tregues mundësojnë identifikimin e problemit përmes sistemit të paralajmërimit të hershëm me qëllim - ndërmarrjen e masave korrigjuese. Njëkohësisht, përfaqësojnë dhe tregues që tregojnë për nevojën e vlerësimit të thukhtë.

Treguesit e realizimit janë mjete efikase për matjen e progresit në raport me qëllimet e parapara, por ata mund të kenë shumë mangësi. Mangësitë tipike dhe gabimet që mund të ndodhin janë: përkufizimi pasaktë dhe i gabuar, vendosja e shumë treguesve, ose grup i treguesve që mund të sigurojnë verifikimin, përkatësisht vërtetimin e të dhënave.

I gjithë ky informacion duhet të jepet para fillimit të zbatimit të politikave publike, sepse kjo është gjendja e pamundur për të marrë përsëri në fillim, për të marrë informacion bazë në lidhje me atë - kur puna ka filluar, e

situata ndryshon. Por nëse kjo ndodh, është e mundur për të kontrolluar në aspektin e marrjes së informacioneve prej atyre që janë përfshirë nga fillimi - a ju kujtohet gjendja e mëparshme?

Nëse bëhen lëshime, për shembull - nuk vendosen treguesit kryesorë dhe nuk vërtetohet cilat janë të dhënat themelore për fillin, atëherë është e nevojshme puna të kthehet - prapa. Kemi thënë - këta informacione mund të merren nga bisedat me disa persona të caktuar dhe mund të shqyrtohen raportet ose procesverbalet, dhe burime të tjera të ngjashme të shkruara. Kur nuk ka informacione themelore, atëherë mënyra për të bërë një krahasim të arsyeshëm është duke krijuar grupe të kontrollit. Grupet e njësive të kontrollit mbi të cilat politika nuk ka efekt, por struktura dhe përmbajtja janë shumë të ngjashme me ato që punojnë. Kjo ndërmerret në rastin e fundit, në qoftë se nuk ka kritere të tjera të qarta në bazë të së cilëve mund të bëhet krahasimi.

Indikatorët e procesit dhe treguesit e ndikimit

Kjo ndarje është jashtëzakonisht e rëndësishme për sa i përket përdorimit të tyre në vlerësimin e ndikimit. Indikatorët e procesit tregojnë nëse në aktivitetet që kemi planifikuar janë zbatuar siç duhet, kurse treguesit për ndikimin nëse është arritur efekti përfundimtar që pritet.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme vendosja e këtyre dy llojeve të treguesve para zbatimit të politikave, sepse me to matim nëse kemi arritur efektin e dëshiruar, dhe deri në çfarë mase. Për më tepër, në qoftë se efekti nuk është arritur nëse arsyeja është zbatimi i pamjaftueshëm i politikave, d.m.th. nëse procesi nuk është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme, ose thjeshtë - supozime në lidhje me rezultatet e pritshme politike nuk janë arritur, sepse politika (e cila) bëhet - nuk është adekuate. Në këtë rast, ne duhet të punojmë për krijimin (e) politikës së re, d.m.th. - (pas) ndryshimit të mëtejshëm dhe përshtatjen e politikës.

Identifikimi i problemit

Për të matur ndikimin, është e nevojshme për të identifikuar problemin ose për të siguruar të dhëna për gjendjen që ka ekzistuar përpara fillimit të zbatimit të politikave të përshtatshme. Në aspektin e politikave të veçanta konkrete për të reformuar sistemin gjyqësor, është e nevojshme për të identifikohen mangësitë që qojnë në vendosjen e qëllimeve, sepse këto do të ndihmojnë në procesin e vlerësimit për të vlerësuar - nëse masat dhe aktivitetet e ndërmarra kanë dhënë rezultatin e pritshëm, pra nëse dhe në cilën masë është arritur qëllimi. Për këtë qëllim, është e nevojshme të përcaktohet nëse të dhënat në gjendjen e mëparshme janë në dispozicion të publikut dhe a janë relevante.

Vizioni i Zhvillimit - imazhin e dëshiruar për një zone problematike

Nga burimet që kemi është e nevojshme për të përcaktuar qëllimin që duam të arrijmë, konkretisht nëpërmjet politikës së zbatuar për të rritur pavarësinë e gjyqësorit dhe se ky synim është vendosur siç duhet. Për të identifikuar objektivat që duhet të arrihen, lidhur me këto çështje si burime mund të përdoren ligjet kombëtare dhe dokumentet strategjike, atëherë objektivat e përgjithshme të përcaktuara në to, si dhe të objektivat e përcaktuara me masat dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Zhvillimi i treguesve të ndikimit

Zhvillimi i realizimit – pasqyra e dëshiruar për fushën problematike, jep treguesit e realizimit, përkatësisht qon drejt shenjave që tregojnë se vizioni është arritur.

Zhvillimi i treguesve të procesit

Ato përfshijnë masat që ju lejon për të matur se si të arrihen rezultatet.

3. Kriteret për monitorim dhe vlerësim

Kur treguesit do të vendosen, ata duhet të analizohet në kuptimin që do të jenë të krahasueshëm dhe të mundësojë kritere universale të vlerësimit. Vendosja e kritereve të vlerësimit është domosdoshme për monitorimin dhe prezantimin e rezultateve të suksesshme. Kriteret janë qasje konsistente dhe të standardizuar për të mundësuar krahasimi i duhur dhe analizë të rezultateve. Sipas OECD-së, Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, ka pesë kritere kryesore të vlerësimit: efikasitetit, efektivitetit, ndikimit, rëndësisë dhe

qëndrueshmërisë. Varësisht nga tema e vlerësimit dhe të qëllimeve, disa kritere do të jenë më të rëndësishëm e të tjerët më pak. Sipas subjektit të vlerësimit, mund të zbatohen kritere plotësuese.

Efikasiteti

Efikasiteti është një nga kriteret themelore. Ai mat qëndrueshmërinë ekonomike të një politike apo aktiviteti të veçantë, përkatësisht - marrëdhëniet në mes burimeve hyrëse dhe rezultatit të drejtpërdrejtë. Është themelor për shkak se në shumë raste, të hollat në drejtim të intensitetit të ndikimit, janë një faktor shumë i rëndësishëm në vlerësimin e suksesit të një politike. Vlerësimi i efikasitetit të vlerësojë rezultatet dhe informacionet hyrëse sasiore dhe cilësore. Gjatë vlerësimit të efikasitetit duhet të bëhet krahasim me qasjet alternative që do të japin të njëjtin rezultat, për të parë nëse është përdorur qasja më efikase. Gjatë kësaj duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- Vallë burimet hyrëse janë ndarë për të siguruar koston më të ulët të mundshme?
- Vallë aktivitetet janë kryer në mënyrën e duhur?
- Vallë harxhimet indirekte janë bërë në minimum?
- Vallë gjatë zbatimit të politikës janë parandaluar apo zgjidhur konfliktet?
- A janë arritur rezultatet në periudhën e planifikuar dhe në kuadër të buxhetit të planifikuar?

Efektiviteti

Efektiviteti është një masë e shkallës në të cilën rezultatet e aktiviteteve që ndikojnë në përmbushjen e qëllimeve të politikës. Aktivitetet do të konsiderohen se janë efektive nëse kanë kontribut të rëndësishëm për arritjen e objektivave të synuar. Edhe pse efikasiteti dhe efektiviteti janë të vazhdueshëm, megjithatë, vlerësimi pozitiv i një kriteri nuk do të thotë automatikisht se kriteri tjetër është vlerësua pozitivisht.

Vlerësimi i efekteve nga politikat e ndërmarra mundëson të supozohet se cili do të jetë rezultati përfundimtar nëse aktiviteti ose politika absolutisht nuk është zbatuar. Atëherë do të fitohet edhe pasqyrë më e qartë një pamje më të qartë të neto- efekteve të politikave, veçanërisht atje ku rezultatet nuk janë menjëherë të dukshme. Në vlerësimin e efektivitetit ne kemi nevojë të dimë hapat që janë paraqitur më poshtë:

- Matja e efekteve - në krahasim me situatën e mëparshme për zbatimin e politikës;
- Rishkrim i ndryshimeve / efekteve si rezultat i politikës së ndërmarrë;
- Vlerësimi i efekteve, në përputhje me objektivat e përcaktuara;

Rëndësia

Kriteret e vlerësimit duhet të jenë relevante, pra të jenë në përputhje me qëllimet, prioritetet dhe politikat. Në thelb, kjo duhet të ketë lidhje logjike midis efekteve të aktiviteteve të ndërmarra / politikave dhe ndikimin e tyre në qëllimet e vendosura.

Ndikimi

OEBZh-ja përcakton ndikimin si përmbledhje e të gjitha ndryshimeve pozitive dhe negative (efektet), që dalin si rezultat i një politike dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të dëshirueshëm ose të padëshirueshëm. Në këtë drejtim, ndikimi matet me aspekte të të gjitha efekteve të mundshme ekonomike, politike, sociale, ekologjike, teknologjike në nivel lokal, kombëtar ose rajonal.

Qëndrueshmëria

Kriteri i qëndrueshmërisë referohet në të- nëse përfitimet dhe efektet e një politike të caktuar do të vazhdojnë pas zbatimit të politikave, ose - nëse efektet e kësaj politike do të japin përfitime afatgjata për përdoruesit përfundimtarë. Qëndrueshmëria është një kriter shumë i rëndësishëm, sepse në qoftë se efektet janë të njehershme, në këtë rast nuk duhet të vazhdohet me zbatimin e kësaj politike, pra duhet të gjendet një politikë e re që në vazhdimësi do të japë rezultate të qëndrueshme

Zhvillimi i indikatorëve për efektivitetin

Më poshtë janë dhënë shembuj të treguesve që duhet të na mundësojnë të vlerësojmë këtë shifër, përkatësisht gjendjen me të cilën duhet të përmbushen parakushtet;

- Progresi në pavarësinë e gjyqësorit, është theksuar në disa raporte nga ana e Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, etj. ;

- Më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për zgjidhen nga gjyqtarët në të gjitha instancat, dhe me respektimin e pluralizmit në gjyqësi;
- Vendimet e Këshillit Gjyqësor janë të argumentuara ku rregullisht dhe sistematikisht publikohen në faqen e internetit;
- Rritja e normës fikse për buxhetin gjyqësor në shumën prej x% të PBV-së

Zhvillimi i indikatorëve për efikasitet

Sa para do të harxhojmë, sa kohë do të jetë e nevojshme, se sa njerëz do të angazhohen, etj.

4. Sistem për grumbullimin e informacioneve

Krijimi i një sistemi për grumbullimin e informacionit është një element thelbësor për monitorimin e suksesshëm të zbatimit, sepse mundëson grumbullimin e informacioneve në kohë, në mënyrë të organizuar dhe të unifikuar. Sistemi paraqet vegël me të cilën do të përcaktohen - të jenë të përfshirë në krijimin e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin, si dhe në cilën mënyrë është realizuar. Gjithashtu, kjo vegël mund të përdoret për të përcaktuar një ekzemplar të përshtatshëm i cili do të shërbejë në grumbullimin e të dhënave. Përveç kësaj, ky sistem tregon palët e interesuara janë të përfshira, ai siguron një vlerësim të interesave të tyre, lidhjen e tyre me politikën dhe mënyrën se si duhet ndaj tyre të kryhet monitorimi dhe vlerësimi. Ka disa arsye pse palët e interesuara të caktuara duhet të përfshihen në vlerësim. Ndoshta mund të kenë nevojë të jenë të përfshirë, për shkak të rolit të tyre në zbatimin e politikës; si përfaqësues të një komuniteti apo një grupi ose nëngrupi të synuar; kanë informacione thelbësore ose shkathtësi në proces; kanë fuqinë, dhe karakteristika të ngjashme. Pjesëmarrja nuk do të thotë vetëm përfshirja në të gjitha fazat në çdo kohë, por do të thotë edhe të mendohet me kujdes, se si të sigurohen interesat e ndryshme të përfaqësohen në faza të ndryshme dhe në forume të ndryshme në procesin e monitorimit dhe vlerësimit.

Për më tepër, sistemi parashikon krijimin kohor për grumbullimin e të gjitha informacioneve të nevojshme, duke identifikuar kompetentët për grumbullimin dhe përzgjedhjen e informacioneve, burimeve relevante përkatëse të informacionit, por edhe përcaktimin kapaciteteve, burimeve dhe resurseve që janë në dispozicion për grumbullimin e informacioneve. Në këtë fazë duhet të përcaktohen dhe metodat që do të përdoren për grumbullimin e të dhënave, si dhe rreziqet e mundshme gjatë grumbullimit dokumentimit të informacioneve.

Grumbullimi dhe dokumentimi i informacioneve

Pasi të vendosen indikatorët, vendoset sistemi për grumbullimin e informacioneve, grumbullohen të dhënat elementare, dhe pas kësaj mund të filloj grumbullimi i informacioneve të nevojshme për vëzhgim dhe vlerësim. Për këtë ekzistojnë një sërë metodash. Secila prej tyre ka specifika, anë pozitive dhe negative ndërsa ekipi që e zbaton projektin duhet të vendos cilat metoda do t'i zbatoj. Më mirë është të bëhet kombinim i më shumë metodave që rezultatet të jenë sa më relevante, e me këtë edhe leksione e përfituara do të jenë më të vlefshme dhe më të zbatueshme. Më poshtë në tekst është dhënë përshkrim i metodave kyçe për grumbullimin e informacioneve për vëzhgim dhe vlerësim, është treguar zbatimi i tyre dhe të dhënat që, sipas gjitha mundësive, do t'i sigurojnë.

Shqyrtimi i dokumentacionit

Qëllimi i kësaj metode është që përmes shqyrtimit të dokumentacionit në formë të shkruar, elektronike, fotografike apo si video regjistrim, të kuptohet rrjedha, realizimi dhe ndikimi i politikës. Kjo metodë mund të siguroj informacione elementare për fushën me rëndësi politike apo për ndonjë indikator të caktuar. Shqyrtimi i dokumentacionit mund të jetë ndërrim për konfirmimin e indikatorëve elementar dhe për konfirmimin e realizimit të indikatorëve të realizimit. Kufizimet ekzistojnë në lidhje me atë se kjo metodë kryhet vetëm ndaj dokumentacionit të kapshëm, por edhe nga fakti se suksesi i tij varet se nga kush është prezantuar dokumentacioni, si është ruajtur dhe çfarë cilësie posedon.

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë

Me këtë metodë, përmes vëzhgimit fitohen informacione të dobishme dhe në kohë. Kjo pastaj ndihmon që të merren vendime, qëllimi i të cilave është përmirësimi i realizimit apo përfitimin e njohurive që do të shërbejnë si hipoteza për studim më të fokusuar. Nga perspektiva e vëzhgimit të vlerësimit, kjo metodë është kritike për

plotësimin e të dhënave të grumbulluara, mund të përdoret që të mësohet konteksti në të cilin janë grumbulluar ato ndërsa mund të ndihmojnë edhe në shpjegimin e rezultateve. Që të jetë kjo metodë e suksesshme, së pari duhet të konfirmohet korniza konceptuale dhe drejtimit në lidhje me atë se çfarë duhet të vëzhgohet. Gjithsesi, nevojitet që të zgjidhet vëzhgues apo grup vëzhguesish.

Informacionet që mund të grumbullohen në këtë mënyrë, nuk mund të grumbullohen në tjetër mënyrë. Më pas, mund të mësohet shumë përmes vëzhgimit të asaj që e bëjnë njerëzit, të lidhjeve të tyre të ndërsjella dhe lidhjeve me komunitetin. Përgjigjet e fituara mund të verifikohen me pyetje të kryqëzuara. Gjithsesi, ekzistojnë kufizime gjegjësisht stereotipat dhe paragjykimet që i ka vëzhguesi, por edhe i vëzhguari ndaj vëzhguesit. Stereotipat dhe paragjykimet asnjëherë s'mund të eliminohen plotësisht, kështu që prej këtu, observimi i drejtpërdrejtë, si metodë sistematike për monitorim dhe vlerësim, patjetër duhet të jetë komplementar dhe shtesë e metodave tjera.

Pyetësor dhe anketa

Qëllimi i kësaj metode është grumbullimi i të dhënave nga numër më i madh i njerëzve, në mënyrë të strukturuar, sipas pyetjeve të caktuara që mundësojnë analizë statistikore. Nga perspektiva e monitorimit dhe vlerësimit, pyetësorët dhe anketat formojnë bazë për shumë studime sepse ato mundësojnë grumbullim të fokusuar të të dhënave për realizime specifike, përmes pyetjeve apo indikatorëve të ekzemplarit. Kuptohet, nevojitet të vendoset çfarë të dhëna nevojiten dhe si të zbatohet hulumtimi. Pyetësorët janë formularët me pyetje, që përdoren për grumbullimin e të dhënave nga të anketuarit. Anketa është më e gjerë dhe ajo mund të përfshinë pyetësorë më të gjatë, apo një ose dy pyetje. Ajo përfshin hulumtim ku hulumtuesit i sjellin konkludimet e tyre sy më sy, përmes intervistës, përmes telefonit, përmes postës apo përmes e-mailit.

Për shkak se është shtrenjtë të bëhet anketë me të gjithë palët e përfshira prej të cilave nevojiten informacione, kjo vegël zbatohet ndaj një grupit të caktuar (ekzemplar). Ekzemplari duhet të përgjigjet dhe t'i paraqet veçoritë dhe strukturën e të gjithë të përfshirëve në proces. Që të fitohen rezultate më të saktë dhe relevant nga anketa, që do t'i prezantojnë qëndrimet e të gjithë palëve të përfshirë, nevojitet të zgjidhet ekzemplarë përkatës dhe reprezentativ.

Ekzistojnë disa lloje të zgjedhjes së ekzemplarit reprezentativ për anketim, prej të cilave më i thjeshti është, ekzemplari i rëndomtë i rastit, ku të gjithë palët e përfshira në proces kanë probabilitet të barabartë për t'u zgjedhur. E dyta, mënyra më sistematike është përmes ndarjes në grupe (stratum) të të gjithë palëve në proces, sipas veçorive të ndryshme, pas çka merren ekzemplarë reprezentativ nga çdo grup. Ekzemplari i shtresuar përmbledhës paraqet grup të ekzemplarëve të rëndomtë dhe të rastit, të përzgjedhur si ekzemplarë nga çdo stratum. Madhësia e ekzemplarit mund të jetë proporcionale me madhësinë e stratumit apo e barabartë me nivelin e variabilitetit të veçorisë së vëzhguar.

Lloji i tretë i ekzemplarit reprezentativ është ekzemplari i tërësive dhe ekzemplarit me më shumë etapa, që përdoret kur kemi grup të madh të palëve të përfshira në proces e që nuk mund t'i definojmë saktësisht. Rasti kur me ekzemplarin përfshijmë të gjitha njësitë e tërësive të përzgjedhura, quhet ekzemplar i rëndomtë i tërësive të caktuara të zgjedhura. Nëse me ekzemplarin nuk përfshihen të gjitha elementet e tërësive të zgjedhura, por vetëm një pjesë e tyre, atëherë formohet, ekzemplari i disa etapave. Lloji i katërt është ekzemplari sistematik, që paraqet metodë statistikore ku përzgjedhja e elementeve është bërë sipas rendit sistematik.

Pyetësorët dhe anketat mund të jenë të thjeshtë dhe shumë të komplikuar. Ato mund të kenë formë specifike të pyetjeve të mbyllura me përgjigje "po/jo", pyetje me më shumë përgjigje apo të përfshijnë pyetje të hapura siç është, për shembull, intervista gjysmë e strukturuar. Pyetjet me mundësi të përzgjedhjes janë të mira për grumbullimin e të dhënave të cilat më vonë të analizohen në aspekt statistikor. Pyetjet me mundësi për përgjigje të lira mund të jenë të mira që të kuptohen ndjenjat apo qëndrimet e njerëzve. Sidoqoftë, që të jenë përgjigjet të dobishme, pyetjet patjetër duhet të jenë të formuluar në mënyrë sa më të mirë të mundshme. Ato duhet të formulohen që të përshtaten me informacionin që është i nevojshëm për vlerësimin e indikatorëve. Gabimet e shpeshtë që paraqiten janë, përzgjedhja e ekzemplarit shumë të madh, parashtrimi i shumë pyetjeve apo ekzemplari të mos jetë reprezentativ. Në këtë rast, analiza bëhet shumë e komplikuar, merr shumë kohë dhe humb dobinë.

Intervistë gjysmë e strukturuar

Kjo metodë përdoret që të grumbullohen informacione të dorës së parë nga individë apo nga një grup i vogël, përmes serisë së pyetjeve gjatë bisedës, por edhe përmes lënies së hapësirës së mjaftueshme për pyetje të reja që mund të dalin si rezultat i diskutimit. Nga perspektiva e monitorimit dhe vlerësimit, intervistat gjysmë të strukturuar janë kyçe për kuptim të thellë të problemeve kualitative. Fakti që intervistat janë të hapura (por me drejtime të caktuara të parashtruara prej më herët), ato janë të dobishme për vlerësimin e ndikimit të paplanifikuar (pozitiv apo negativ).

Që kjo metodë të jetë e suksesshme, së pari duhet të definohet qëllimi dhe të vërtetohet cilat informacione nevojiten si dhe të bëhet listë për gjërat më të nevojshme. Pyetjet duhet të jenë të parashtruara, pas çka të intervistuarit do të mundin përmes diskutimit t'i shprehin qëndrimet e tyre. Gjithashtu, nevojitet para kohe të dihet kush do të intervistohet, sa persona nevojiten për ekzemplarin dhe se a do të zhvillohet intervista individualisht apo në grup. Nëse zhvillohet intervistë në grup me më shumë se një të intervistuar, atëherë është mirë që të intervistuarit të njihen me zhvillimin e procedurës dhe dinamikës së saj. Intervistën duhet ta udhëheq ndonjë person me përvojë dhe që e kupton tematikën, ka shkathtësi që e inkurajojnë diskutimin. Personi i njëjtë duhet të jetë dëgjues dhe bashkëbisedues i mirë.

Pyetjet duhet të jenë të strukturuar në mënyrë ku do të kërkojë përgjigje të hollësishme, në vend të deklaratave pohuese apo mohuese. Të shpeshtën intervistat gjysmë të strukturuar i udhëheqin dy persona, ku njëri udhëheq intervistën ndërsa tjetri vëzhgon hollësisht, përfshirë këtu edhe citate. Intervistat mund të regjistrohen, por se kjo mund të ndikoj që të intervistuarit të jenë të rezervuar. Pyetjet duhet paraprakisht të testohen që të konfirmohet nëse janë të saktë në mënyrë përkatëse ndërsa përgjigjet e fituara të mund të analizohen si duhet. Pyetjet që parashtrihen gjatë intervistës gjysmë të strukturuar të shpeshtën janë të llojit të hapur, me qëllim që të intervistuarit t'i mundësohet liri në shprehjen e qëndrimeve të tija, pa i ofruar më pas përgjigje të mundshme të pyetjes së parashtruar.

Intervistat gjysmë të strukturuar, në veçanti ato grupe, mund të përdoren të kombinuara me metoda tjera, si p.sh metodat vizuale ndërsa përdoren që të fitohen informacione cilësore që nuk mund të fitohen përmes pyetësorëve të strukturuar, por tek intervistat gjysmë të strukturuar nuk mund të zbatohen analizat statistikore. Informacionet e fituara në përgjigje me pyetje të hapura vështirë mund të sintetizohen që të fitohen rezultate të qarta. Është vështirë të mbahen të anketuarit të fokusuar ndërsa vështirë është të zbatohen përgjigje të ndryshme. Prej këtu, është shumë e rëndësishme të merren vërejtje të sakta. Është shumë e rëndësishme që të përdoret gjuhë e thjeshtë, që të mund të kuptojnë të gjithë të anketuarit ndërsa gjatë intervistave grupe duhet të insistohet të evitohet konflikti në grup, që mund të krijohet për shkak të pyetjeve kontroverse politike apo kulturore, e që patjetër duhet të parashihen prej më herët. Numri i pyetjeve dhe kohëzgjatjes tek intervistat gjysmë të strukturuar konfirmohen prej më herët sepse varen nga diskutimi që mund të zhvillohet gjatë intervistës. Megjithatë, ekziston kornizë prej 60 deri 90 minutave, që duhet të jetë e pranueshme që të mundësohet nivel i mjaftueshëm i përqendrimit nga të dyja palët.

Grupet e fokusit

Përmes grupeve të fokusit grumbullohen informacionet e diskutimit grupor, që të sqarohen detaje të caktuara apo që të merren mendime për çështje të caktuar nga grup i vogël i njerëzve të zgjedhur që kanë pikëpamje të ndryshme apo të përbashkët. Grupet e fokusit janë të mira që të bëhet vlerësimi i politikave, që të vlerësohet cilësia e politikave apo të identifikohen fushat ku është arritur avancim.

Së pari, duhet të përcaktohen pjesëmarrësit (preferohet katër deri tetë pjesëmarrës) ndërsa varësisht nga qëllimi mund të punohet me grup heterogjen apo homogjen. Në grup duhet të parashtrihen e njëjta pyetje ndërsa për të diskutohet në kohë të paraparë prej më herët (1 orë deri në 2 maksimum).

Struktura e udhëheqjes së grupit të fokusit parasheh disa hapa të rëndësishëm:

- Diskutimi (takimi) i grupit të fokusit fillon me njoftim dhe fjalim hyrës të personit që bën intervistën dhe që duhet të shpjegoj qëllimin e grupit të fokusit, t'i inkurajoj pjesëmarrësit që lirshëm të tregojnë mendimin e tyre dhe t'i tregoj rregullat që duhet të respektohen gjatë diskutimit;

- Më pas prezantohen pjesëmarrësit, por kjo nuk është e obligueshme ndërsa ata mund t'i parashtrojnë pyetje personit që zhvillon intervistën;

-Pjesa esenciale e diskutimit fillon me parashtrimin e pyetjeve dhe temave të diskutimit. Pyetjet që parashtrohen janë të hapura ndërsa pjesëmarrësve ju jepet hapësirë që të shprehin mendimin e tyre. Pjesa hyrëse dhe pyetjet duhet të jenë të planifikuara kështu që do të mundësojnë komunikim dypalësh dhe përfshirje më të madhe të pjesëmarrësve. Fundi i diskutimit duhet të përcillet me përmbledhje dhe identifikim të vërejtjeve përfundimtare të përgjigjeve dhe temave të diskutimit.

Diskutimin e udhëheq personi intervistues, i cili duhet të ketë shkathtësi për zhvillim të diskutimit në grup, minimum të intervencioneve, aq sa t'ju mundësojë të gjithë të shprehin mendimin e tyre. Gjatë diskutimit është e nevojshme që të nxirren vërejtje të hollësishme apo të regjistrohet i tërë diskutimi. Për këtë, përveç intervistuesit, nevojitet të ketë edhe një person që do të vëzhgojë.

Ditari

Ditari është pjesë e grupit të metodave që merren me ndryshimet që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Qëllimi i tij është që detektohen ngjarjet, faktet, reagimet dhe mendimet gjatë një periudhe të caktuar. Është i dobishëm për vërejtjen e detajeve, që mund të lëshohen eventualisht e që mund të shpjegojnë kontekstin në të cilin ka ndodhur ndryshimi. Ditari mund të përdoret që të fokuset vëmendja drejt pyetjeve specifike të realizimit apo drejt indikatorëve të caktuar.

Që kjo metodë të jetë e suksesshme ndërsa procesi i vlerësimit optimal, ditari duhet të mbahet nga faza më e hershme e zbatimit të politikës. Grumbullimi i të dhënave të nevojshme për ditarin mund të zhvillohet përmes metodave të ndryshme, që më lartë janë përshkruar si intervista të strukturuar, anketa, pyetësorë, grupe fokusi, vëzhgime e kështu me radhë. Forma e ditarit është edhe dokumentacioni i procesit, që përfshin përshkrim të hollësishëm të proceseve, ngjarjeve dhe problemeve që ndodhin gjatë kohës së zhvillimit të politikave. Ditarët janë metodë e thjeshtë dhe e kapshme dhe janë të mirë për vet- vlerësim. Ato mund të ofrojnë njohuri të vlefshme, por kyçe është shkathtësia për shkrimin e atij që i zhvillon si dhe disiplina për shënim të kujdesshëm.

Studimi i rastit

Qëllimi i kësaj vegle është që të dokumentohet tregimi jetësorë apo sekuenca jetësore në periudhë të caktuar kohore, që ka të bëjë me person, lokacion apo amvisërisë të caktuar, që të fitohen njohuri për ndikimin e politikës. Njohuritë nga zbatimi i kësaj vegle tregojnë se shfrytëzuesit përfundimtar dhe palët e përfshirë ballafaqohen me ndryshimin dhe pse ndryshimi ndodh në mënyrë specifike ndërsa nga zbatimi i veglës mund të mësohet edhe për pritjet e palëve të përfshira dhe për pengesat në lidhje me planet e tyre të ardhshme.

Që kjo vegël të jetë e saktë, duhet më parë të definohet qëllimi dhe të identifikohet lënda e studimit. Është e nevojshme të vërtetohet si do të grumbullohen të dhënat (përmes intervistës, dokumenteve, matje biofizike etj). Nëse të dhënat grumbullohen përmes intervistës, atëherë intervistuesi patjetër duhet të ketë shkathtësi të mira komunikuese ndërsa mund të paraqitet nevoja intervistat të përsëriten disa herë. Përparësia e kësaj vegle është se mundëson të grumbullohen shumë detaje për një temë specifike. Megjithatë, në përgjithësi, studimet e rastit nuk konsideron si reprezentative, kështu që është mirë të kombinohen me metoda tjera që përfshijnë hulumtime ndaj ekzemplarëve më të mëdhenj, si për shembull anketat apo pyetësorët.

5. Analiza e informacioneve të grumbulluara- vegla për analizë cilësore

Ky proces përfshin analizën konkrete apo vlerësimin. Cilësia e realizimit të fazave të mëhershme duhet të sigurojë se të gjitha të dhënat që janë grumbulluar, janë në kontekst të indikatorëve, të rezultatit dhe qëllimit për të cilin është zbatuar politika. Më tej, duhet të tregon se janë grumbulluar të dhëna relevante që pasqyrojnë gjendjen reale në shtet apo në krahinë, në grupin e caktuar, tek palët e përfshira, të cilëve ju dedikohet politika. Varësisht se cili prej dy llojeve të vlerësimit është lëndë e analizë gjegjësisht për cilin vlerësim janë grumbulluar të dhënat, mund të bëhet fjalë për vlerësim të procesit dhe vlerësim të ndikimit.

Vlerësimi i procesit

Vlerësimi i procesit fokusohet në pjesën operative të zbatimit të politikës gjegjësisht vlerëson nëse mënyra e zbatimit të politikës është në përputhje me dizajnin e planifikuar për zhvillim dhe punë. Për dallim nga

vlerësimi i ndikimit, shpenzimet dhe korniza kohore për zbatimin e këtij vlerësimi janë relativisht më të vogla ndërsa rezultatet apo informacionet e fituara nga ky vlerësimi mundën në masë të madhe të përdoren për përmirësimin e zbatimit të politikës.

Vlerësimi i procesit është i rëndësishëm për shkak të aspekteve vijuese:

- I identifikon zgjidhjet më të mira të mundshme që do të shfrytëzohen si praktika më të mira;
- Ndihmon në interpretimin e rezultateve të fituara nga vlerësimi i ndikimit- nëse vlerësimi i ndikimit tregon se ndonjë politikë nuk i ka arritur efektet e pritura, atëherë vlerësimi i procesit mund t'i gjejë shkaqet dhe sqarimin për rezultatet e fituara;
- Ndihmon më mirë të kuptohet konteksti politik dhe institucional i politikës- sepse ndonjëherë krijohet politikë që nuk është më efikase, por politikisht e arsyeshme;
- Të dhënat e fituara nga ky lloj i vlerësimit shfrytëzohen në drejtim të përmirësimit të politikës;

Në kuadër të zbatimit të vlerësimit të procesit më së shpeshti kryhen aktivitetet vijuese:

- Vlerësimi i nivelit deri ku politika është në pajtim me kornizën e vendosur inicuese logjike të rezultateve të pritura, si dhe përgatitjen e revizionit të kornizës (modelit);
- Punëtori të dedikuara për palët e prekura dhe për shfrytëzuesit e fundit të politikës publike, që kanë për qëllim t'i shikojnë të gjitha komentet dhe rekomandimet për atë se si zhvillohet dhe çfarë ndodhë me zbatimin e politikës publike;
- Anketa dhe intervista me shfrytëzuesit e fundit për t'u mësuar mendimi i tyre për politikën publike;
- Analiza të dokumenteve lidhur me politikë të caktuar.

Vlerësimi i ndikimit

Vlerësimi i ndikimit paraqet identifikim sistemor të efekteve- pozitive ose negative, të planifikuara ose të paplanifikuara, të shkaktuara nga ndonjë aktivitet i caktuar me zbatimin e ndonjë politike të caktuar publike, në program ose projekt, në krahasim me gjendjen status quo. Vlerësimi i ndikimit jep përgjigje në pyetjen për lidhjen shkak-pasojë nga ndonjë politikë e caktuar publike, gjegjësisht tregon- cili është efekti ndryshimit të caktuar ndaj rezultatit përfundimtarë. Përveç se bën identifikimin e lidhjes së shkakut mes një aktiviteti të caktuar dhe rezultatit përfundimtarë, kjo metodë e vlerësimit jep rezultate edhe për efikasitetin e politikës publike.

Vlerësimi shkon më larg se ideja: **çfarë duhet të mësohet?**, drejtë idesë- **pse është e nevojshme të mësohet(dihet)?**

Vlerësimi i ndikimit është i lidhur ngushtë me procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit, dhe nuk do duhej të kryhet në mënyrë të pavarur. Nëse mbikëqyrja dhe vlerësimi ex-ante sigurojnë informata për qëllimet e politikës, për mënyrën e krijimit dhe për zbatimin, si dhe masa për efektet e mundshme dhe ato aktuale nga intervenimi mbi shfrytëzuesit e fundit, atëherë vlerësimi i ndikimit jep vlerësimin e saktë për atë nëse shfrytëzuesit e fundit vërtetë kanë dobi nga politika, e jo nga faktorë tjerë. Vlerësimi më i mirë është kombinim i të gjitha këtyre qasjeve dhe mjeteve. Disa nga mjetet që mund të shfrytëzohen gjatë vlerësimit të ndikimit do të shqyrtohen më poshtë në tekst, por përdorimi i tyre varet nga ajo se cila politikë është lëndë e vlerësimit. Megjithatë, patjetër të theksohet se vlerësimi i ndikimit dhe vlerësimi i procesit janë procese komplementare dhe nuk duhet të paraqesin zëvendësim për njëra tjetrën. Informatat që do të fitohen nga vlerësimi i procesit deri diku janë të domosdoshme gjatë vërtetimit të rezultateve nga ndikimi. Pasi vlerësimi i ndikimit është proces që nevojitet më shumë kohë dhe resurse të konsiderueshme, ai aplikohet me përzgjedhje , por rekomandohet gjatë marrjes dhe zbatimit të politikave me rëndësi strategjike.

6. Mjete për qasje kuantitative në vlerësimin e ndikimit

Analizë e shpenzimeve dhe dobive (Cost- Bebefit Analysis)

Qëllimi i kësaj metode është sigurimi i formës përmes së cilës do të llogaritet vëllimi i shpenzimeve dhe dobive që kanë të bëjnë me vendimin, që të shmangen aktivitetet e shtrenjta, e që kanë dobi të pakta. Përdorimi

standard i kësaj metode është të vlerësohet politika, përmes krahasimit të masave të vërteta për shpenzimet dhe dobitë në raport me ato që janë propozuar gjatë dizajnit të tyre. Përdorimi tjetër është- të llogariten shpenzimet dhe dobitë nga elementet e politikës, siç janë aktivitetet specifike ose indikatorët.

Më mirë është që këtë metodë ta realizojë ndonjë ekonomist me përvojë ose ndonjë ekspert për këtë lloj analize, sepse metoda nënkupton shfrytëzimin e formulave të ndryshme për llogaritjen e shpenzimeve dhe dobive gjatë zgjatjes së politikës. Nëse realizohet si duhet, kjo analizë ka disa dobi. Ajo mundëson kornizë gjithëpërfshirëse për lidhje sistematike të shpenzimeve dhe dobive. Ajo u mundëson çalëve të kyçura të mendojnë rreth detajeve, dhe jep pasqyrë të qartë për qarkullimin e parave. Por, kjo analizë gjithashtu është shumë e kritikuar sepse është vështirë në mënyrë precize dhe të llogaritshme të bëhen të gjitha shpenzimet dhe dobitë e mundshme. Shumë vështirë është të maten disa shpenzime dhe dobi të caktuara, siç janë: shpenzimet jo materiale dhe shpenzime sociale jofinanciare dhe shpenzimet e ambientit jetësor, e sidomos ato që kanë efekte afatgjatë në të ardhme të pasigurt, si dhe dobitë që duhet të paraqiten shumë më vonë. Prandaj, kjo analizë patjetër të realizohet me kujdes, nga ana e ekonomistëve me përvojë dhe ekspertëve të informatikës, në mënyrë që të parashikohen opsionet e mundshme, si dhe për shkak të kompleksitetit matematikor të kësaj metode.

Cost- effectiveness- Efektiviteti të kostos

Analiza e efektiviteti të kostos “Cost- effectiveness” paraqet mjet ekonomik për vlerësimin e shpenzimeve dhe efekteve nga më shumë opsione alternative lidhur me arritjen e qëllimit të njëjtë apo të përafërt. Ndonëse e afërt me analizën “Cost-benefit”, ky mjet përdoret për llogaritjen e efekteve alternative që është vështirë të definohen ose të llogariten në njësi monetare, prandaj tregohen njësi fizike. Analiza e efektiviteti të kostos të politikës korrekte shprehet përmes llogarisë së raportit të resurseve të nevojshme/shpenzimeve dhe efekteve të arritura.

